




UDHËZUES

PËR ZBATIMIN E LIGJIT

“PËR GJENDJEN CIVILE”

NË REGJISTRIMIN E LINDJES SË FËMIJËS



TLAS

TIRANË 2020

UDHËZUES

PËR ZBATIMIN E LIGJIT
“PËR GJENDJEN CIVILE”
NË REGJISTRIMIN E LINDJES
SË FËMIJËS



Përgatitur nga:

Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë
Tirana Legal Aid Society, TLAS
www.tlas.org.al
tlas@tlas.org.al

Tiranë 2020

PËRMBAJTJA:

Hyrje	3
Qëllimi	7
Regjistrimi i lindjes së fëmijës nga prindërit	8
Regjistrimi i fëmijëve në mungesë të veprimit nga prindërit	13
Regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	22
Regjistrimi i lindjes nëpërmjet vendimit gjyqësor	26
Aneks:	
Aneks 1: Model kërkesë e përdorur nga avokatët e TLAS	32
Aneks 2: Pjesë të dispozitave të ligjit nr. 10 129, datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile" (i ndryshuar)	39
Aneks 3: Udhëzim për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes të fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes	45
Aneks 4: Udhëzim për krijimin, administrimin dhe përditësimin e regjistrit të përkohshëm për lindjet e raportuara	48
Aneks 5: Udhëzim për përcaktimin e procedurës administrative që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile kur në aktin e lindjes mbajtur jashtë Republikës së Shqipërisë është e pa plotësuar rubrika e emrit	54
Aneks 6: Udhëzim i përbashkët për përcaktimin e veprimeve dhe procedurës që kryejnë nëpunësit e zyrave të gjendjes civile dhe personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor, për përfitimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura	60
Aneks 7: Vendim për përcaktimin e masës dhe të procedurës së dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të shërbimit spitalor dhe tyre të gjendjes civile	65

UDHËZUES

PËR ZBATIMIN E LIGJIT “PËR GJENDJEN CIVILE”¹ NË REGJISTRIMIN E LINDJES SË FËMIJËS

Kujdesi për fëmijët është trajtuar në shumë akte ndërkombëtare si një përgjegjësi shoqërore. Është e natyrshme që fëmijët janë në pamundësi të kujdesen për veten e tyre dhe për rrjedhojë shoqëria merr përsipër detyrimin të përkujdeset për ta. Kjo përgjegjësi është e pranishme në shumë marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve pasi është vlerësuar si një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm të çdo shoqërie. Përkujdesja për fëmijët duhet vlerësuar më së pari si një dobi shoqërore pasi, mënyra se si rriten fëmijët përcakton të ardhmen e shoqërisë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe harmonik.

Të kujdesesh për fëmijët do të thotë t’u garantosh atyre jetën, shëndetin, mirëqënien, ushtrimin e të drejtave në përputhje me zhvillimin e personalitetit duke mundur që këto të drejta të mos përbëjnë një dëshirë, por një mundësi reale.

Me qëllim që përkujdesja ndaj fëmijëve si një dobi shoqërore të realizohet në mënyrë efektive, një moment i rëndësishëm është pasqyrimi i këtij koncepti në legjislationin përkatës të çdo vendi.

Republika e Shqipërisë ka aderuar në një numër të madh marrëveshjesh ndërkombëtare që përcaktojnë detyrime konkrete për Shqipërinë në përgjegjësitë e saj për t’u përkujdesur për fëmijët.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara ka shpallur që fëmijët kanë të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë.

¹ Ligji nr. 10 129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” ndryshuar përmes ligjeve nr.6/2012, nr. 135/2013, nr. 134/2016 dhe nr. 69/2018 si dhe vendimit nr. 52 datë 1.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

Ndërsa Konventa e Kombeve të Bashkuara "Për të drejtat e fëmijës" miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 44/25 datë 20.11.1989, në nenin 7 të saj, ka parashikuar shprehimisht të drejtën e fëmijës për t'u regjistruar menjëherë sapo lind, të drejtën për të pasur një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

Shteti shqiptar ka marrë masa në vazhdimësi për të përshtatur legjislacionin në dobi të interesave të fëmijëve edhe duke reflektuar përm-bushjen e detyrimeve nga aktet ndërkombëtare. Përkujdesja ndaj fëmijës është pasqyruar para së gjithash në ligjin themelor.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 54 ka parashikuar shprehimisht se:

"1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa.

3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal."

Ligji Nr. 18/ 2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm legjislativ. Ky ligj kompletoi mungesa të rëndësishme legjislative, qoftë në përcaktimin më të qartë dhe të plotë të të drejtave të fëmijës, por edhe sepse përcaktoi detyrime konkrete të organeve specifike publike në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, si një hap të rëndësishëm për të garantuar me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijëve.

Është për t'u theksuar sidomos fakti se ky ligj, edhe për shkak të rëndësisë së veçantë si një ligj kryesor në mbrojtje të fëmijëve, rritet parimin e rëndësishëm të prioritetit të "interetit më të lartë të fëmijës" në veprimtarinë e çdo institucioni që do të përfshihet në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës, parim i cili ishte i pranishëm edhe më parë në legjislacionin shqiptar që rregullon veprimtarinë gjyqësore në të cilën trajtohen ineteresa të fëmijës (Kodi i Familjes).

Regjistrimi i fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile përbën një moment shumë të rëndësishëm për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Regjistrimi lidhet me thelbësisht me vetë ekzistencën e fëmijës në pikëpamje ligjore, pasi vetëm pas regjistrimit fëmija mund të realizojë të drejtat që parashikon legjislacioni si dhe mbrojtjen nga rreziqet që mund t'i kanosen. Një fëmijë i pa regjistruar nuk mund të realizojë asnjë të drejtë që lidhet me detyrimin e shoqërisë për përkujdesje, duke filluar që nga të drejtat më bazike si, njohja e prindërve, e drejta për përkujdesje spitalore, e drejta për t'u arsimuar, e drejta për të patur një shtetësi të caktuar, etj si dhe rrezikohet të bëhet objekt i veprimtarive kriminale të trafikimit etj. pasi nuk ka një person të ngarkuar ligjërisht me përgjegjësinë e përkujdesjes e cila ka në bazë përgjegjësinë prindërore ose kujdestare.

Rëndësia e regjistrimit të fëmijës bëhet edhe më e qartë nga fakti që kjo e drejtë është sanksionuar në aktet më të rëndësishme ndërkombëtare që parashikojnë detyrimet e shteteve për të garantuar të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Regjistrimi i fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile është përballur me sfida të vazhdueshme.

Nuk ka patur një kuptim të qartë të "regjistrimit të lindjes" si një e drejtë e rëndësishme e fëmijës nga subjektet e përfshira në këto procedura duke e vlerësuar si një procedurë formale të parashikuar nga ligji.

Për rrjedhojë, në vazhdimësi një numër i konsiderueshëm fëmijësh kanë mbetur të pa regjistruar në gjendjen civile. Shkaqet kanë qenë të ndryshme, por ato legislative kanë patur një ndikim të veçantë.

Legjislacioni shqiptar ka parashikuar regjistrimin e fëmijës si një detyrim të prindërve me plotësimin që institucionet shtetërore kanë detyrimin të përfshihen në këtë proces vetëm në rastet e fëmijëve të braktisur nga prindërit. Për rrjedhojë, neglizhenca e prindërve apo vështirësitë e tyre për të realizuar procedurat e regjistrimit mbeteshin të parregulluara me një detyrim të shprehur shtetëror.

Vetëm me amendimet e Ligjit Nr. 69/2018, Ligji nr. 10 129, datë 11.05.2009 " Për Gjendjen Civile" (këtu e më poshtë referuar "Ligji"), u krijua baza e nevojshme legislative për të detyruar angazhimin e institucioneve shtetërore për të bërë të mundur regjistrimin e fëmijëve në rastet e neglizhencës së prindërve, apo personave të afërm të fëmijës, apo për të ndihmuar prindërit të kapërcejnë pengesat për ndjekjen e këtyre procedurave.

Ndryshimet e vitit 2018 e kanë bërë edhe më të qartë konceptin e vlerësimit të procedurës së regjistrimit të lindjes së fëmijës si një të drejtë të fëmijës. Tanimë për prindërit është bërë mëse e qartë se, regjistrimi i fëmijës nuk është "e drejtë" për ta, por "detyrim ligjor". Me ndryshimet ligjore, prindërit mosveprues duhet të qartësohen se mosveprimi i tyre për regjistrim përfaqëson mospërmbyllje të detyrimeve ligjore të tyre në raport me fëmijën dhe për rrjedhojë rrezikon masa ligjore nëse neglizhenca e tyre dëmton interes të fëmijëve dhe ata nuk bashkëpunojnë. Vetë termi i legjislacionit "përgjegjësi prindërore" tregon qartë se prindi biologjik, para se të shohë raportin me fëmijën si një kënaqësi prindërore, duhet të ndërgjegjësohet se kjo kënaqësi është e bashkëshoqëruar me detyrime të rëndësishme prindërore në raport me fëmijën. Ky koncept është shumë i rëndësishëm të kuptohet drejt edhe nga punonjësit publik të angazhuar në mbrojtje të fëmijëve për të qartësuar prindërit kur u kërkojnë atyre bashkëpunim për të realizuar procedurat ligjore të regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile.

Qëllimi i Udhëzuesit është t'u vijë në ndihmë punonjësve të gjendjes civile, punonjësve të ngarkuar me mbrojtjen e fëmijëve si dhe çdo aktori të përfshirë drejtëpërdrejtë apo tërthorazi në procedurat e regjistrimit të fëmijëve të njohin më mirë rregullat e zbatueshme nëpërmjet situatave konkrete të ndryshme me synimin final që asnjë fëmijë të mos mbetet i pa regjistruar.

Ky Udhëzues ofron një sqarim të plotë të legjislacionit, përfshirë edhe aktet nënligjore që janë të zbatueshme për regjistrimin e lindjes së fëmijës qoftë ky i lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

Udhëzuesi përpiqet të ofrojë kuptim sa më të qartë për çdo hap procedural për të finalizuar regjistrimin e lindjes së fëmijës në Regjistrin Kombëtar. Në këto procedura përfshihen shumë aktorë, përfshirë por pa u kufizuar, prindërit e fëmijës, të afërm të fëmijës, avokatë të cilëve mund t'u drejtohen prindërit, avokatë apo punonjës të organizatave jo-fitimprurëse të fokusuara në mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, punonjës të gjendjes civile, punonjës të institucioneve spitalore të lindjes së fëmijës, punonjës të ngarkuar me mbrojtjen e fëmijëve (Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve), punonjës të organeve të rendit, psikologë, etj. Secili prej aktorëve, nëpërmjet këtij Udhëzuesi do të kuptojë më drejtë rëndësinë e procedurës së regjistrimit të lindjes, për të mos e konsideruar atë thjesht si një procedurë formale administrative apo gjyqësore por të vlerësojë drejtë rëndësinë e pasojave që prodhon kjo procedurë.

Në mënyrë të veçantë punonjësit e gjendjes civile, si funksionarët më të rëndësishëm vendimmarrës në këtë proces kanë një rol të rëndësishëm. Nisur nga koncepti që "regjistrimi i lindjes së fëmijës përfaqëson një të drejtë për fëmijën dhe detyrim për shoqërinë", ato nuk duhet të vlerësojnë detyrën e tyre vetëm nga pikëpamja teknike, por duhet të tregohen aktivë për t'u krijuar subjekteve deklaruese mundësi efektive për të realizuar procedurën e regjistrimit. Natyrisht vlerësimi i kujdesshëm nuk mund të konsiderohet si "mbyllje e syrit" për të lejuar regjistrimin e lindjes në kundërshtim me dispozitat ligjore, por si një përgjegjësi për të sqaruar mekanizmat efektivë që do të mundësojnë finalizimin e procedurës.

Dokumenti i vlefshëm për regjistrimin e lindjes

Ligji Nr. 10 129 ka parashikuar si dokument të vlefshëm të regjistrimit të lindjes, *“çertifikatë asistencë në lindje, raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.”*

Institucionet e shërbimit spitalor publik janë të pajisur me modelar ***“çertifikatë asistencë në lindje”***, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas Udhezimit nr. 870, datë 24.12.2018, në të cilin janë përcaktuar informacionet e domosdoshme që shërbejnë për regjistrimin e fëmijës siç janë: emri/mbiemri dhe numri i identitetit tënënës; data e lindjes, ora, gjinia e fëmijës (dokument i cili mbahet në dy kopje).

E rëndësishme është që dokumenti të jetë në formën zyrtare, pra të përcaktohet qartë funksioni i personit që lëshon dokumentin duke identifikuar edhe institucionin përkatës nëpërmjet nënshkrimit të funksionarit dhe vulës përkatëse.

Në eksperiencën e avokatëve të TLAS janë konstatuar edhe raste të vështirësisë së sigurimit të dokumentave nëse lindja e fëmijës ka ndodhur jashtë institucioneve spitalore.

Në këto raste ligji duhet kuptuar nëpërmjet interpretimit në frymë dhe në tekst. Fjalja *“raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm,”* duhet kuptuar në qëllimin e vet, pra që personeli mjekësor krijon bindje të plotë për vërtetësinë e faktit të lindjes, lidhur me nënën që ka lindur fëmijën, kohën, vëndin dhe gjininë e fëmijës nëpërmjet verifikimit të drejtëpërdrejtë. Pra, nëse personeli mjekësor kontakton nënën që ka lindur fëmijën në një kohë të mëvonshme të arësyeshme që, për shkak

të eksperincës dhe njohurive mjekësore bindet për vërtetësinë e faktit, ai mund të përpilojë dokumentin e nevojshëm që vërteton lindjen e fëmijës.



RAST NGA PRAKTIKA

B.A. është një grua Rome nga Korça. Ajo është 'e martuar' dhe nënë e dy fëmijëve. B.A. është e pa regjistruar pa si nëna e saj e lindi jashtë maternitetit dhe në kushte shtëpie. Si pasojë ajo nuk ka qënë e pajisur asnjëherë me një dokument që të vërtetonte lindjen e saj. B.A. ka jetuar jashtë Shqipërisë për shumë vite dhe ka përdorur dokumente false. Jeta e saj ka qënë shumë e vështirë dhe askush nga familja e saj nuk ka arritur ta regjistrojë lindjen e saj. Po ashtu ajo ka lindur edhe dy fëmijë të cilët gjithashtu janë të paregjistruar. Duke qënë e paregjistruar ajo e ka të pamundur të lidhë dhe martesën ligjore me bashkëjetuesin e saj.

Dokumenti i paplotë/pasaktë

Dokumenti që lëshohet për efekt të regjistrimit të lindjes së fëmijës duhet të jetë i plotë dhe i saktë. Kjo pasaktësi apo paplotësi mund të lidhet si me formën, mungesë nënshkrimi apo identifikimi i institucionit nëpërmjet vulës, ashtu edhe në rubrikat përkatëse që përmban dokumenti.

Në këto raste organi që ka lëshuar dokumentin ka edhe detyrimin të plotësojë apo korigjojë gabimet materiale në të. Në këto raste punonjësit e gjendjes civile duhet të tregohen aktivë për të ndihmuar deklaruesit në udhëzime të dobishme që ndihmojnë në plotësimin apo korigjimin e dokumentit duke informuar në formë të shkruar mungesat e konstatuara në dokument. Përvoja e avokatëve të TLAS ka treguar se jo rrallë, për shkak të informacioneve të paplota për shkaqet e mospranimit të dokumentit për të kryer regjistrimin e lindjes së fëmijës, shtetasit janë vënë në pamundësi reale për të realizuar korigjimin apo plotësimin e dokumentit.

Në eksperiencën e avokatëve të TLAS janë evidentuar edhe raste në të cilat, për shkak të plotësimit të identitetit të nënës mbi intervistën e saj verbale (në rastet e mungesës së dokumentit identifikues) janë pasqyruar në mënyrë të pasaktë rubrika që lidhen me identitetin e nënës. Nëse këto gabime konstatohen në kohë të shpejtë, është plotësisht e mundur që këto gabime të ndreqen në formën e ndreqjes së gabimeve materiale nga vetë institucionet spitalore të lindjes (neni 112 i Kodit të Procedurave Administrative) duke verifikuar nëpërmjet ballafaqimeve pasaktësitë në çertifikatën e asistencës së lindjes.

Kush mund të bëjë deklarin e lindjes

Sipas nenit 40.1 të Ligjit, "Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme."

Nga përmbajtja e dispozitës, pavarësisht se përgjegjësia prindërore u takon prindërve, Ligji ka përcaktuar një rreth më të gjërë personash për të legjitimuar deklarin e lindjes. Është e qartë se dispozita kërkon të lehtësojë sa më shumë procedurën e regjistrimit të lindjes me synimin që t'a bëjë sa më efektiv këtë proces.

Në praktikë kërkohet të vlerësohet në mënyrë më të kujdesshme koncepti i "pjesëtarëve madhorë të familjes" duke kuptuar si të tillë personat e afërm të prindërve pavarësisht faktit nëse ato janë ose jo të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile si të tillë. Duhet mbajtur në konsideratë se "regjistrimi në fletën familjare të familjes" prezumon gjendjen familjare, por nga ana tjetër mungesa e këtij regjistrimi kërkon provueshmërinë e kësaj gjendje familjare me dokumenta plotësuese.

Ku mund të bëhet deklarimi i lindjes

Në nenin 41 të Ligjit është parashikuar se: "Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja."

Parashikimi i alternativave të vendit në të cilin bëhet regjistrimi i lindjes duhet vlerësuar si një element procedural lehtësues për të realizuar regjistrimin nga subjektet e përcaktuara nga Ligji si "deklarues" në një nga zyrat alternative në të cilën ato kanë aksesin më të lehtë për ta realizuar.

Afati i deklarimit


Ndër vite Ligji ka pësuar ndryshime të rëndësishme përsa i përket afatit të deklarimit. Pas kapërcimit të paradoksit për ndëshkimin me gjobë të deklarimeve të vonuara apo të procedurës gjyqësore detyruese për procedura të vonuara, Ligji aktual "ka fshirë" çdo afat për deklarimin e lindjes së fëmijës, duke pasqyruar kështu frymën e konceptit të regjistrimit të lindjes si një e drejtë e fëmijës që nuk duhet të vështirësohet për shkak të neglizhencës së subjekteve të ngarkuara me deklarimin.

Megjithatë, nisur nga përvojat e mëparshme negative të përdorimit të afatit të deklarimit në formë ndëshkuese, Ligji ka parashikuar afatin 60 ditor për deklarimin e lindjeve brenda vendit dhe 90 ditor për lindjet jashtë vendit, si një afat inkurajues.

Nesë deklarimet e lindjeve bëhen brenda afateve të përcaktuara, nënat me foshnjat e porsalindura përfitojnë çekun në vlera financiare: për fëmijën e parë në masën e shpërblimit 40 000 lekë, për fëmijën e dytë 80 000 lekë dhe për fëmijën e tretë 120 000 lekë.

Këto përfitime dhe procedurat e realizimit të tyre janë rregulluar me VKM Nr. 740, datë 12.12.2018 si dhe me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të

Brendshëm, Nr. 870, datë 24.12.2018, "Për përcaktimin e veprimeve dhe procedurës që kryejnë nëpunësit e zyrave të gjendjes civile dhe personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor për përfitimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të sapolindura". Udhëzimi i sipërcituar parashikon procedura lehtësuese për realizimin e përfitimit financiar nga prindërit për foshnjat e lindura. Qënia "i përbashkët" favorizon edhe procedurën e regjistrimit të lindjes pasi kërkon prezencën e punonjësve të gjendjes civile pranë institucioneve spitalore të lindjes.



REGJISTRIMI I FËMIJËVE NË MUNGESË TË VEPRIMIT NGA PRINDËRIT

Dokumenti i vlefshëm për regjistrimin e lindjes

Konceptimi i drejtësi regjistrimit si një e drejtë e fëmijës dhe për rrjedhojë si një detyrim të shoqërisë për ta mundësuar është sanksionuar në mënyrën më të plotë në përmbajtjen e nenit 41 "1" të Ligjit. Kjo dispozitë e shtuar, ka plotësuar mungesën e ndërhyrjes së mekanizmeve publikë në rastet e mosveprimit të subjekteve deklaruese (kryesisht prindërve) në afatin inkurajues të parashikuar nga Ligji.

Ligji ka parashikuar në mënyrë të shprehur detyrimet e aktorëve publikë për të bashkëpunuar nëpërmjet raportimit të detyrueshëm për çdo lindje të fëmijës.



RAST NGA PRAKTIKA

Në mars të 2018 në maternitetin e Gjirokastrës ka lindur fëmija i gjinisë femër, nga nëna F.Ç. Sipas deklarimit të nënës femija ka ardhur në jetë nga bashkëjetesa e saj me shtetasin A.K. Meqenëse fëmija ka ardhur në jetë nga një lidhje jashtëmarte-sore ka mbetur e pa regjistruar, pasi F.Ç., (nëna e fëmijës) ishte në proces divorci. Fëmija është mbajtur nga nëna F.Ç. dhe gjyshja (nëna e F.Ç) për një periudhë 6-mujore, dhe më pas i është dorëzuar familjarëve të bashkëjetuesit të nënës A.K. (i pretenduar si baba biologjik), konkretisht gjyshes nga babai me inicialet J. K.

Në janar të 2019, J.K, pasi ishte kujdesur për disa muaj për mbesën, paraqiti një kërkesë drejtuar Drejtorisë së Shërbimit Social të qytetit ku banonte, ku shprehej se, për arsye social-ekonomike e kishte të pamundur të vazhdonte të kujdesej për mbesën e saj, e cila kishte mbetur pa kujdes prindëror, pasi nëna e fëmijës, F.Ç. ishte larguar dhe nuk interesoej më për vajzën e mitur, ndërsa babai i pretenduar i fëmijës ishte dënua me një dënim penal në kushtet e heqjes së lirisë.

Njësisia e Mbrojtjes së Fëmijeve (NJMF) e vendbanimit të fëmijës, sapo u njoh me rastin, ju drejtua gjykatës me një kërkesë për vendosjen e përkohshme në kujdestari alternative të fëmijës. Kërkesa u pranua nga gjykata dhe femija u vendos nën kujdesin e një institucioni përkujdesje për fëmijë në Gjirokastër. NJMF gjithashtu ju drejtua Agjensisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për udhëzime të mëtejshme pasi fëmija rezultonte ende i pa regjistruar në zyrat e gjendjes civile. Si pasojë e bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet rasti u referua pranë TLAS për vazhdimësinë e procedurave për regjistrimin e fëmijës.

Detyrimet e punonjësve të institucioneve spitalore për raportimin e lindjeve

Sipas nenit 41 "1", "Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore, publike dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që, për çdo lindje të ndodhur pranë institucioneve të tyre, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, dokumentacionin/njoftimet përkatëse."

Ndonëse detyrimi i raportimit ka qenë i pranishëm edhe më parë në Ligj, u konstatua se ky parashikim nuk rezultoi efektiv.

Ndryshimi thelbësor i Ligjit lidhet me administrimin e të dhënave që duhet të raportohen, duke shoqëruar raportimin me detajimin e bashkëpunimit me akt nënligjor (Udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) të , "Modaliteteve, llojet e dokumentacionit, formën dhe mënyrën e komunikimit ndërmjet institucioneve".

Udhëzimi i Përbashkët nr. 870, datë 24.12.2018, me titull "Për përcaktimin e veprimeve dhe procedurës që kryejnë nëpunësit e zyrave të gjendjes civile dhe personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor për përfitimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura, si dhe komunikimin mes këtyre institucioneve dhe zyrave të gjendjes civile për regjistrimin e lindjeve" ka përcaktuar në detaje modalitetet e bashkëpunimit. Udhëzimi ka parashikuar bashkëpunimin e ngushtë të punonjësve të gjendjes civile dhe punonjësve të institucioneve të shërbimit spitalor shtetëror, publik ose privat ku ndodh lindja e fëmijës, duke detyruar atashimin e një punonjësi të gjendjes civile pranë çdo institucioni të shërbimit spitalor shtetëror, publik ose privat.

Ky organizim i bashkëpunimit synon të lehtësojë përmbushjen nga prindërit të detyrimit ligjor për deklarimin e lindjes së fëmijës. Nëpërmjet këtij organizimi, prindi ka mundësi reale të deklarojë lindjen e

fëmijës menjëherë pas lindjes, sapo të jetë përpiluar nga punonjësi i institucionit shëndetsor dokumenti "çertifikatë asistencë në lindje". Udhëzimi detyron institucionet e shërbimit spitalor që të ndihmojnë prindërit me informacionet e nevojshme për mundësinë e deklarimit të lindjes drejtëpërdrejtë pranë punonjësit të gjendjes civile të atashuar pranë institucionit spitalor.

Dokumenti që përpilon punonjësi i institucionit të shërbimit spitalor shtetëror, publik ose privat ku ndodh lindja e fëmijës, i emërtuar "çertifikatë asistencë në lindje" duhet të përpilohet në dy kopje. Një kopje i vihet në dispozicion prindit të fëmijës së lindur, ndërsa kopja tjetër së bashku me fotokopjen e dokumentit të identitetit, i jepet zyrtarisht (dorëzohet) me proceverbal nga institucioni i shërbimit spitalor tek nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor, në përfundim të çdo dite.

Udhëzimi ka parashikuar edhe modalitetet e detyrimeve të personelit spitalor për rastet e lindjeve të ndodhura jashtë institucionit të shërbimit spitalor. Edhe në këto raste, personeli shëndetësor që asiston lindjen ka detyrimin e plotësimin të "çertifikatës asistencë në lindje", dhe pajis me një kopje të saj prindin/prindërit dhe kopjen e dytë e dorëzon brenda 5 diteve nga data e lindjes së fëmijës në zyrën e gjendjes civile në territorin ku ka ndodhur lindja.

I rëndësishëm është edhe parashikimi nga Udhëzimi i detyrimit të institucioneve të rakordojnë ndërmjet tyre lindjet e raportuara çdo ditë të hënë (një herë në javë) me synimin që rastet e lindjeve të raportuara në përditshmërinë e komunikimit të korigjohen.

Ligji dhe Udhëzimi i Përbashkët kanë krijuar mundësi reale për efektivitetin e procesit të raportimit të lindjeve. Ndërsa në praktikën e mëparshme të raportimit referoheshin vetëm informacione të përgjithshme për lindjet e ndodhura në institucionet e lindjeve, baza e re legjislative e shndërron raportimin në përcjellje dokumentash të vlefshme për të realizuar një procedurë të plotë regjistrimi të lindjes.

Tanimë pranë punonjësve të gjendjes civile do të disponohen dokumenta të plotë dhe me vlerë ligjore për të përfunduar një procedurë regjistrimi.

Regjistri i Përkohshëm

Themelimi i një Regjistri të Përkohshëm në funksion të kontrollit më të plotë të regjistrimit të lindjeve, përbën edhe risinë më të rëndësishme për angazhimin publik për regjistrimin e lindjes së fëmijëve në rastet e mospërbushjes së detyrimeve të prindërve për të deklaruar lindjen e fëmijës.

Koncepti i përkohshmërisë lidhet me faktin se personat e regjistruar në këtë regjistër ende nuk kanë statusin e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të gjendjes civile. Për rrjedhojë ky regjistrim nuk krijon në mënyrë të plotë të drejtat që kanë personat e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të gjendjes civile.

Në zbatim të detyrimit të përcaktuar në nenin 41 "1" të Ligjit, Ministri i Brendshëm ka miratuar Udhëzimin Nr. 285, datë 11.03.2019 " Për krijimin, administrimin dhe përditësimin e Regjistrit të Përkohshëm për lindjet e raportuara".

Në këtë regjistër të përkohshëm do të regjistrohen;

"a) për të gjithë fëmijët e lindur në institucione spitalore, për të cilët ka marrë njoftimin prej këtyre institucioneve dhe ndërkohë personat që kanë të drejtën dhe detyrimin e deklarimit nuk janë paraqitur para nëpunësit për të mbajtur aktin e lindjes;

b) për të gjithë të lindurit, për të cilët nëpunësi i gjendjes civile, pasi është njohur me kërkesën e deklaruesit konstaton se nuk mund të mbajë akt lindjeje, për shkak se dokumenti "asistencë në lindje" ose raporti mjekësor është me pasaktësi ose ka rubrika të paplotësuara;

c) për të gjitha rastet kur deklaruesi nuk ka dokument që vërteton lindjen;

ç) për rastet kur akti i lindjes i mbajtur jashtë vendit ka pasaktësi ose është i paplotë në rubrikat e tij;

d) si dhe çdo rast tjetër që konstatohet i paregjistruar, për të cilin nuk mund të mbahet akt lindje në momentin e konstatimit/deklarimit.”

Nga rastet e regjistrueshme në këtë regjistër është e dukshme përpjekja legjislative që të mos mbetet asnjë fëmijë i paregjistruar. Qëllimi i këtij rregjistrimi është i shumëanshëm. Natyrisht që vlera më e rëndësishme është verifikimi i regjistrimit të çdo fëmije të lindur me synimin që të angazhohen strukturat e ndryshme publike për të ndihmuar apo zëvendësuar prindërit që neglizhojnë apo janë në vështirësi për të realizuar një procedurë të plotë regjistrimi të fëmijës së lindur.

Përveç kësaj vlere, regjistri i përkohshëm do të ketë vlerë edhe për të plotësuar të drejtat e fëmijëve të pa regjistruar në Regjistrin Kombëtar të gjendjes civile përsa i përket plotësimit të të drejtave për arsim, trajtim shëndetësor ose përfitimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, apo në çdo aspekt tjetër për të cilin ka interes të ligjshëm. Për këtë qëllim fëmijët e regjistruar në regjistrin e përkohshëm mund të pajisen me dokument konfirmues për ta përdorur për të realizuar të drejtat e sipërcituara.

Regjistri është i vlefshëm për regjistrimin e çdo fëmije me shtetësi shqiptare pavarësisht faktit nëse lindja e fëmijës ka ndodhur brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Detyrimet e punonjësve të gjendjes civile për lindjet e raportuara Detyra më e rëndësishme e punonjësit të gjendjes civile është mirë-administrimi i të dhënave që përmban regjistri i përkohshëm duke u përkujdesur që të pasqyrohet me korrektesë çdo rast i fëmijëve të paregjistruar në Regjistrin Kombëtar por edhe i pasqyrimin të të dhënave të plota, përfshirë shkakun e mungesës së regjistrimit në Regjistrin Kombëtar. E rëndësishme është që punonjësi i gjendjes civile të kuptojë rëndësinë e këtyre të dhënave për qëllimin e regjistrimit të fëmijës.

Pas regjistrimit është përgjegjësi e punonjësit të gjendjes civile të ndjekë dhe monitorojë ecurinë e veprimeve të mëtejshme për fëmijët e regjistruar në regjistrin e përkohshëm. Për këtë qëllim Udhëzimi, parashikon mundësinë e përdorimit të programeve kompjuterike për të lehtësuar ndjekjen e vazhdueshme të problematikave të regjistrit të përkohshëm. Regjistri i përkohshëm (konceptuar në formën e një moduli) duhet të përmbajë edhe opsionin e njoftimit të punonjësit të gjendjes civile në rastin e kalimit të afatit 60-ditor nga data e lindjes. Me kalimin e afatit 60-ditor të përmendur më lart, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kryen këto veprime:

- kontrollon nëse të dhënat e regjistruara për lindjen dhe/ose regjistrimin janë regjistruar përfundimisht në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Në rast se është bërë regjistrimi i të dhënave për personin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, atëherë nëpunësi i gjendjes civile vendos në modul shënimin: "E zgjidhur".

- në rast se nëpunësi i gjendjes civile konstaton se fëmija nuk është regjistruar ende në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, atëherë në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm, Nr. 284, datë 11.03.2019 "Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes të fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre brenda 60 ditëve nga data e lindjes", njofton me shkresë zyrtare për këtë fakt drejtuesin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin përkatës.

Detyrimet e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës Ligji Nr. 18/ 2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ndër të tjera, ka për qëllim "parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".

Duke prezumuar se e drejta për t'u regjistruar në Regjistrin Kombëtar të gjendjes civile përfshihet ndër të drejtat më të rëndësishme të fëmijës si dhe, faktit se struktura më e specilazuar për të garan-

tuar mbrojtjen e fëmijës janë punonjësit e "autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës", Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm "Për mbajtjen e aktit të lindjes të fëmijëve në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditë nga dita e lindjes", ka përfshirë në këtë proces edhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijës.

Zgjerimi në Ligj i subjekteve të deklarimit të lindjes, duke parashikuar në nenin 40 si deklarues edhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, ka rritur në mënyrë të konsiderueshme mundësinë efektive të ndërhyrjes publike në procedurën e regjistrimit të lindjeve në rastet e mosveprimit të prindërve.

Për rrjedhojë Ligji ka plotësuar mungesën e angazhimit të institucioneve publike në mënyrë aktive për të arritur qëllimin e rëndësishëm të regjistrimit të lindjes të çdo fëmije.

Duhet qartësuar se zëvendësimi i prindit si deklarues duhet të vlerësohet si veprimi më i fundit i punonjësve të mbrojtjes së fëmijës. E drejta e fëmijës për t'u regjistruar, e shoqëruar me të drejtën për të njohur prindërit (nëpërmjet regjistrimit) duhen konsideruar si nevojë e ndihmës për prindërit që të përmbushin detyrimin e deklarimit.

Sipas Udhëzimit, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës duhet të tregohet i kujdesshëm në evidentimin e rasteve të raportuara nga punonjësit e gjendjes civile duke krijuar një dosje të veçantë për çdo fëmijë duke përfshirë në të si dokumentat e dërguara nga punonjësi i gjendjes civile ashtu edhe ato që prodhohen në aktivitetin e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës.

Gjithashtu, punonjësi duhet të marrë masa të shpejta për vendosjen e menjëhershme të kontaktit me prindërit apo të afërmit madhorë të fëmijës të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin për deklarimin e lindjes.

Udhëzimi cakton afate të shkurtra por të arsyeshme për këto veprime të punonjësit të mbrojtjes së fëmijës.

Këto takime duhet të synojnë sqarimet e nevojshme lidhur me;

- a) Detyrimin për regjistrimin e fëmijës, në gjendjen civile sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) Përfitimet dhe domosdoshmërinë për regjistrimin e fëmijës së lindur në gjendjen civile;*
- c) Informon pasojat se, nëse nuk regjistrohet fëmija i lindur brenda afatit të caktuar kohor të përcaktuar, procedura e regjistrimit të fëmijës së lindur, do të kryhet prej njësisë së mbrojtjes së fëmijëve*

Duhet kuptuar se këto kontakte nuk mund të jenë formale por duhet të synohen të jenë efektive. E rëndësishme është të vlerësohen këto takime si nevojë bashkëpunimi prind- punonjës i mbrojtjes së fëmijës në interesin më të lartë të fëmijës. Prindi mund të ndodhet në vështirësi të kryerjes së deklarimit për shkak të mungesës apo paplotësisë së dokumentacionit të kërkuar. Për këtë qëllim punonjësi duhet të sqarojë prindin si dhe ta ndihmojë atë për të kapërcyer pengesat. Nëse kërkohet ndihmë ligjore duhet të ndihmojë atë konkretisht qoftë me informacione të dobishme por edhe me kontaktet e nevojshme me strukturat që mundësojnë këtë ndihmë, veçanërisht organizata që janë të specializuara në këtë kategori të ndihmës ligjore.

Nëse prindi nuk tregohet bashkëpunues dhe tregon neglizhencë, apo ka kaluar afati 10 ditor i përcaktuar në Udhëzim, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës kryen vetë deklarimin e lindjes së fëmijës pranë punonjësit të gjendjes civile. Në këto raste, meqë është vepruar pa pëlqimin e prindit, emri i fëmijës konsiderohet i përkohshëm, duke u pasqyruar ky fakt në rubrikën shënime në aktin e lindjes, për t'u dhënë mundësinë prindërve, apo fëmijës kur të bëhet madhor për të zgjedhur ata emrin e fëmijës.

Në përvojën e avokatëve të TLAS janë konstatuar raste të mosveprimit të prindit për shkak të kërkesave të tyre në kundërshtim me ligjin, sidomos përsa i përket atësisë së fëmijës. Në këto raste kërkohet ndihmë juridike për të qartësuar prindin për rrugët procedurale të realizimit të kërkesave të prindit, të cilat mund të jenë të drejta në thelbin e tyre por që nuk mund të realizohen përveç procedurave gjyqësore.

Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës kanë detyrime të ndjekin të gjithë problemet me të cilat mund të përballen fëmijët në territorin përkatës. Gjatë këtij aktiviteti ata mund të vihen në dijeni edhe për raste fëmijësh të paregjistruar qoftë në Regjistrin Kombëtar por edhe në regjistrin e përkohshëm. Në këto raste, punonjësi nuk mund të qëndrojë indiferent meqë rasti nuk i referohet Udhëzimit të sipërcituar, por duhet të sigurojë veprimet e nevojshme për të realizuar regjistrimin e fëmijës, sipas rastit, drejtëpërdrejt në Regjistrin Kombëtar apo fillimisht në regjistrin e përkohshëm (nëse dokumentacioni i paplotë e pengon regjistrimin në Regjistrin Kombëtar).



RAST NGA PRAKTIKA

F.A. është një grua gjashtëdhjetë e katër vjeçare nga Elbasani. Ajo është gjyshja e dy fëmijëve të moshës shtatëmbëdhjetë e katërmëdhjetë vjeç që janë të paregjistruar. Nipërit e saj kanë lindur nga një lidhje jashtë martesore e nënës së tyre. Babai i fëmijëve nuk e njohu asnjëherë atësinë ndaj fëmijëve. Fëmijët kanë lindur në Francë, ku vajza e F.A. jetonte për shumë vite. Pasi vajza e F.A. u kthye në Shqipëri me fëmijët e saj disa vite më parë, ajo vdiq në një aksident. F.A. i mori fëmijët nën kujdesin e saj. Prej shumë vitesh ata jetojnë në Shqipëri dhe F.A. po përballen me një pamundësi të vazhdueshme për t'i regjistruar ata. Ajo arriti të merrte disa dokumente nga Franca, por zbuloi se vajza e saj kishte përdorur identitet të rremë gjatë qëndrimit atje, për këtë arsye F.A. nuk mund të dëshmojë lidhjen e saj me fëmijët. F.A. trajtohet me ndihmë ekonomike mirë po autoritetet rrezikojnë t'ja ndërpresin nëse fëmijët nuk regjistrohen dhe ajo dhe fëmijët nuk përfitojnë asnjë shërbim apo mbështetje tjetër.

REGJISTRIMI I FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Sipas nenit 41 të Ligjit, "Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi i lindjes mund të bëhet edhe në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin ku ka ndodhur lindja."

Lëvizjet e shpeshta demografike janë shoqëruar me fenomenin e pashmangshëm që shumë shtetas shqiptarë banojnë përkohësisht apo në afate të zgjatura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjatë kësaj kohe është e natyrshme që nga këta shtetas të lindin fëmijë të cilët, për shkak të parashikimit të legjislacionit përkatës të shtetësisë, konsiderohen shtetas shqiptarë. Largësia, angazhimet e përditshme vështirësojnë për këta shtetas procedurën e zakonshme të deklarimit të lindjes pranë punonjësve të gjendjes civile të vendbanimit mund të shkaktojnë mungesën apo pamundësinë e regjistrimit të këtyre fëmijëve në afatin ligjor favorizues (90 ditë) në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Për rrjedhojë legjislacioni ka parashikuar procedura lehtësuese për ta nëpërmjet alternativave të regjistrimit të lindjes pranë shërbimit të gjendjes civile në vëndqëndrimin e tyre ose deklarimin pranë shërbimit diplomatik apo konsullor shqiptar në shtetet respektive si dhe mundësinë e transferimit të të dhënave të aktit të lindjes në gjendjen civile shqiptare në një moment të mëvonshëm.

Regjistrimi i akteve të lindjeve mbajtur jashtë Republikës së Shqipërisë kur në akt mungon plotësimi i rubrikës së "emrit"

Çdo shtet zgjedh procedurat e vlerësuara më të përshtatshme për regjistrimin e lindjes së fëmijëve.

Nga përvojat e avokatëve të TLAS kanë rezultuar raste të shumta të shtetasve shqiptarë që kanë lindur fëmijë jashtë territorit të Shqipërisë dhe që në aktin e lindjes të mbajtur pranë shërbimit të gjendjes civile

të shtetit të huaj nuk kanë të plotësuar rubrikën e emrit të fëmijës. Për shkak të mënyrës së formulimit të mëparshëm të Ligjit, këta shtetas ishin në pamundësi për të realizuar transferimin e të dhënave të këtij akti lindje pasi akti konsiderohej i paplotë dhe për rrjedhojë procedura e transferimit e pamundshme.

Ndryshimi i nenit 45 me shtesën e pikës 3 "a" sipas së cilës, "Kur në aktin e lindjes të mbajtur jashtë vendit është e pa plotësuar rubrika e emrit, plotësimi i saj bëhet në përputhje me procedurën administrative, të përcaktuar me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile", mundëson regjistrimin e këtij akti lindje pa patur nevojën e plotësimit të tij nga organi që e ka lëshuar apo nga gjykata.

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, Ministri i Brendshëm ka miratuar Udhëzimin nr. 286 datë 11.03.2019 " Për përcaktimin e procedurës administrative kur në aktin e lindjes të mbajtur jashtë Republikës së Shqipërisë është e pa plotësuar rubrika e emrit."

Në frymën e Ligjit, sidomos pas ndryshimeve të vitit 2018 me synimin "asnjë fëmijë i lindur të mos mbetet i pa regjistruar", Udhëzimi përcakton detyra konkrete për punonjësit e gjendjes civile për të ndihmuar maksimalisht shtetasit që disponojnë një akt lindje të tillë të paplotë. Udhëzimi parashikon dy skenarë të ndryshëm, skenarin e dokumentit të rregullt dhe të gatshëm për regjistrim (akt lindje i pajisur me vulën "APOSILLE"- meqë është një dokument zyrtar i mbajtur në një shtet të huaj), si dhe skenarin kur shtetasi e disponon dokumentin të papajisur me vulën "APOSTILLE".

Në rastin e parë punonjësi i gjendjes civile të vendbanimit të prindit regjistron fëmijën në Regjistrin Kombëtar duke pasqyruar edhe emrin e zgjedhur në deklaratën e prindërve. Pra, sipas ndryshimeve të Ligjit dhe Udhëzimit mungesa e plotësimit të rubrikës së emrit të fëmijës nuk përbën më shkak për të penguar transferimin e të dhënave të lindjes.

Në skenarin e dytë, regjistrimi në Regjistrin Kombëtar është i pamundur për shkak të parregullsisë së dokumentit, pasi vula "APOSTILLE" është e domosdoshme për të verifikuar origjinalitetin e një dokumenti zyrtar të huaj. Pavarësisht kësaj mungese, Udhëzimi ngarkon punonjësit e gjendjes civile me procedura të posaçme për këto raste.

Veprimi i parë është regjistrimi i aktit në regjistrin e përkohshëm. Ky veprim që duket formal është shumë i rëndësishëm për ecurinë e mëtejshme të procedurës. Regjistrimi i fëmijës në regjistrin e përkohshëm, në kushtet kur edhe pse fëmijët kanë lindur jashtë territorit të Shqipërisë mund të jenë duke banuar në Shqipëri, ndihmon fëmijët për të marrë shërbime të përkujdesjes shoqërore, arsim, shëndëtiesi etj. Përveç kësaj evidentimi i rastit përfaqëson angazhim publik për të ndihmuar prindin në realizimin e plotë të procedurës së regjistrimit të lindjes.

Për këtë arsye, Udhëzimi parashikon detyrimin e punonjësit të gjendjes civile që të udhëzojë prindin për procedurat për të legalizuar dokumentin me vulën "APOSTILLE", dhe nëse prindi është në pamundësi ndihmon prindin duke dërguar, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, dokumentin për legalizim pranë strukturave përkatëse të ministrisë që mbulon punët e jashtme. Kjo veprimtari evidentohet nëpërmjet procesverbalit përkatës që mbahehet me prindin në të cilin pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera nga punonjësi i gjendjes civile.



RAST NGA PRAKTIKA

Fëmija B. H, ka lindur në Athinë, Greqi në 2001, nga dy prindër me shtetësi shqiptare. Kur fëmija u bë tre vjeç, prindërit u kthyen në vendbanimin e tyre në Elbasan, pasi nuk kishin dokumenta të rregullta për të qëndruar në shtetin fqinj. Pas kthimit në Elbasan, prindërit tentuan të regjistrojnë vajzën e tyre në zyrën e gjendjes civile, mirëpo, kërkesa ju refuzua me arsyetimin se “çertifikata e lindjes e lëshuar nga shteti Grek, nuk ishte e rregullt, pasi mungonte rubrika e emrit të fëmijes dhe vula “Apostille”. Për këtë arsye, zyra e gjendjes civile nuk e pranoi për regjistrim. Babai i vajzës, u detyrua të rikthehej në Greqi, për të berë të mundur plotësimin e rubrikës së emrit të vajzës, por pa sukses. Përgjigja ishte përsëri negative me arsyetimin se, “nëna e fëmijës D.H, në kohen e lindjes së vajzës nuk ishte rezidente e rregullt në Greqi dhe, për këtë arsye vajzës “B. H” nuk mund t’i plotësohej rubrika e emrit në aktin e lindjes.

Vajza B. H, ka vazhduar arsimin deri në vitin e tretë të shkollës së mesme, ndërsa më pas ajo e ka braktisur shkollën, pasi i është kërkuar në menyërë të vazhdueshme çertifikata e lindjes.

Në këto kushte që prej lindjes, vajza (19-vjeçare) vazhdon të jetë e pa regjistruar në zyrën e gjendjes civile.



Vërtetimi i faktit të lindjes në mungesë të çdo dokumenti që vërteton lindjen

Eksperienca e avokatëve të TLAS ka konstatuar se ka jo pak raste kur për lindjen e fëmijës nuk është mbajtur dokument ligjor i vlefshëm për regjistrimin e lindjes së fëmijës. Natyrisht që këto janë raste që u përjasin, kryesisht komuniteteve që jetojnë në vështirësi ekonomike apo sociale. Mungesa e një vendqëndrimi të qëndrueshëm apo refuzimi për të lindur në institucionet spitalore sjellin si pasojë lindjet jashtë institucionit dhe, jo rrallë, edhe në mungesë të personelit ndihmës shëndetësor.

Vetë Ligji ka parashikuar mundësinë e regjistrimit edhe të këtyre lindjeve por, në dallim nga rregulli sipas të cilit punonjësi i gjendjes civile verifikon faktin e lindjes nëpërmjet dokumentit zyrtar të mbajtur në momentin e lindjes, në këto raste ky fakt mund të vërtetohet vetëm në rrugë gjyqësore.

Në këto raste, kushdo që vihet në dijeni të këtij fakti duhet të informojë punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve për rastin me qëllim marjen e masave të nevojshme për regjistrimin e këtyre fëmijëve në Regjistrin Kombëtar. Është e nevojshme të përmendim faktin se edhe këta fëmijë, sapo evidentohet rasti duhen të regjistrohen në regjistrin e përkohshëm me qëllim të përfshirjes së strukturave përkatëse për ndihmën e tyre për kujdes shëndetësor, arsimor etj.

Punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve duhet të bashkëpunojnë me strukturat shtetërore të ndihmës juridike falas apo me organizatat jo fitimprurëse që operojnë në këtë fushë për t'u dhënë prindërve ndihmën e nevojshme të ndjekjes së procedurave gjyqësore për regjistrimin e fëmijës. Ligji procedural nuk kufizon gjykatën në prova konkrete për të vërtetuar faktin e lindjes nga një nënë e caktuar. Në praktikë është përhapur opinioni se e vetmja provë e vlefshme për të vërtetuar këtë fakt të lindjes është analiza mjekësore e AND-së. Natyrisht që kjo analizë është një provë me vlerë të konsiderueshme ligjore, por

duhet mbajtur parasysh edhe kosto e lartë financiare e kësaj analize. Për rrjedhojë, subjektet që do të përfshihen në procedurat ligjore të vërtetimit të faktit duhet të bëjnë kujdes për të parë mundësinë e provave të tjera me kosto më të ulët si, dëshmitarë, shkresa të tërthorta që lidhen me lindjen e fëmijës apo prova që tregojnë për raportet e mëparshme të fëmijës me prindërit etj.

Vërtetimi i faktit të lindjes nëpërmjet gjykatës për shkak të aktlindjeve të pasaktë/paplotë të mbajtura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Përvoja e avokatëve të TLAS është përballur me raste të shumta të aktlindjeve të mbajtura jashtë Shqipërisë por që nuk mund të regjistrohen, në formën e transferimit të të dhënave në Regjistrin Kombëtar për shkak të të metave apo mospërputhjes së të dhënave.

Është fakt i njohur se shumë shtetas shqiptarë kanë provuar emigrimin e paligjshëm dhe janë kthyer në Shqipëri me fëmijë të lindur në shtetet respektive. Emigrimi i paligjshëm shpesh është shoqëruar me dokumenta të parregullta për identitetin e tyre, dhe për rrjedhojë këto parregullsi pasqyrohen edhe në aktin e lindjes së fëmijës të mbajtur në shërbimin e gjendjes civile të shtetit të huaj.

Rrjedhojë e këtyre pasaktësive është pamundësia e transferimit të të dhënave të lindjes së fëmijës në Regjistrin Kombëtar e shoqëruar me pasojat negative që bart kjo mungesë regjistrimi për fëmijën.

Avokatët e TLAS janë përballur shpesh me problematika të tilla dhe vështirësia për regjistrimin ka qenë ligjore dhe institucionale. Sipas nenit 388 të Kodit të procedurës Civile,

“Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të

kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.

Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni.”

Duke iu referuar kësaj dispozite avokatët e TLAS janë përpjekur që, në rrugë gjyqësore të plotësojnë të metat apo të korrigjojnë gabimet e këtyre aktlindjeve. Qëndrimet e gjykatave të ndryshme nuk ishin të njësuara pasi veç gjykatave që e pranonin këtë procedurë korrigjimi ka patur edhe gjykata që kërkonin që kjo procedurë të realizohej në vëndin e mbajtjes së aktit nga shteti i huaj, veprim ky pothuaj i pamundshëm për shtetasit shqiptar të kthyer nga emigracioni.

Me ndryshimin e Ligjit, dhe shtesën e nenit 38 “1”, është përcaktuar se:

“1. Në rastet kur akti i lindjes i lëshuar në një shtet tjetër ka të dhëna të paplota ose të pasakta, gjykata bën vërtetimin e faktit juridik të lindjes, me qëllim regjistrimin në zyrat e gjendjes civile.

2. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të lindjes mund ta paraqesin subjektet e parashikuara në nenin 40 të këtij ligji.

3. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në të cilin kanë vendbanimin prindi ose prindërit e fëmijës, për të cilin kërkohet regjistrimi.

4. Gjykata që shqyrton çështjen për vërtetimin e faktit juridik të lindjes, merr vendim brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, duke thirrur, me cilësinë e personit të interesuar, zyrën e gjendjes civile.

5. Nëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ushtrohet ankimi, gjykata e apelit shqyrton ankimin, në dhomë këshillimi, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij.”

Kjo dispozitë e shtuar shuan çdo dyshim mbi juridiksionin e gjykatave shqiptare për të plotësuar apo korigjuar akte lindje të mbajtura në shtete të huaja. Rezultatet konkrete të zbatimit të kësaj dispozite janë tanimë të pranishme në veprimtarinë e gjykatave shqiptare.

Gjykatat shqiptare kanë reaguar pozitivisht duke kuptuar drejt frymën dhe qëllimin e ndryshimit të Ligjit Nr. 10129/ 2009 "Për Gjendjen Civile" me Ligjin Nr. 69/2018. Është për t'u vlerësuar në mënyrë të veçantë kuptimi i drejtë që i ka dhënë zbatimit të kësaj dispozite Gjykata e Lartë. Për shkak të rolit të veçantë që kanë vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë për të orientuar kuptimin e njëlojtë të ligjit nga gjykatat e niveleve më të ulëta, qëndrimet e Gjykatës së Lartë vlerësohen veçanërisht ndikuese në qëndrimin e përgjithshëm të gjykatave për interpretimin e drejtë të ndryshimit të Ligjit.

Për efekte njohjeje më të drejtëpërdrejtë citojmë pjesë të Vendimit Nr. 00-2019-259 datë, 9.05.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; "7.1. Së pari, paditësi ka ngritur padinë e pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për të, sipas nenit 32/c të K.Pr.C, ndërkohë që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka arsyetuar se sipas Ligjit nr. 10 129 "Për Gjendjen Civile", të ndryshuar, paditësi duhet t'i ishte drejtuar gjykatës me kërkesën për vërtetimin e faktit dhe se kjo kërkesë sipas nenit 6, të Ligjit nr. 69/2018 (me të cilin është ndryshuar Ligji nr. 10 129, datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile") duhet të shqyrtohet nga gjykata ku ka vendbanimin pala e interesuar. Kolegji vlerëson se, çështja e kompetencës lëndore do të vlerësohet nga gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen, bazuar në aktet e fashikullit të gjykimit, sipas padisë, objektit dhe shkakut ligjor të identifikuar nga paditësi në momentin e shqyrtimit dhe jo sipas padisë apo kërkesës që në vlerësim të gjykatës, paditësi eventualisht duhet apo mund të kishte ngritur.

7.2. Për më tepër, dispozita mbi të cilën është bazuar Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë për të shpallur moskompetencën lëndore, nuk ka lidhje me çështjen në gjykim. Në rastin konkret, paditësi

nuk ka kërkuar vërtetimin e faktit juridik të lindjes, por ka kërkuar korrigjimin e aktit të lindjes të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Mallakastër, në rubrikën e vendlindjes, pasi ka mospërputhje me aktin e lindjes të lëshuar në lidhje me të, nga organet kompetente në shtetin Grek. Ndërkohë, neni 6 i Ligjit nr. 69/2018, rregullon situatën kur aktet e lindjes të lëshuara në një shtet tjetër mbajnë të dhëna të paplota apo të pasakta dhe do të duhet të bëhet vërtetimi i faktit juridik nga gjykata me qëllim regjistrimin e kërkuarit në zyrat e gjendjes civile.

Reagimi pozitiv rezulton edhe nga praktika gjyqësore pas ndryshimit të Ligjit. Nga 19 kërkesa të avokatëve të TLAS vetëm në një rast nuk është pranuar kërkesa për korrigjimin e pasaktësive. Edhe kërkesa e pa pranuar është plotësuar nëpërmjet ankimit në gjykatën e apelit e cila, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë.



RAST NGA PRAKTIKA

S.A. është një nënë e re nga qyteti i Tiranës. Ajo është pa shtetësi dhe nuk ka asnjë dokument që të dëshmojë identitetin e saj. Ajo ka dy fëmijë që janë gjithashtu të pa regjistruar dhe pa shtetësi. S.A. lindi në vitet nëntëdhjetë ndërsa prindërit e saj jetonin në mënyrë të pa rregullt në Gjermani. Në kohën e lindjes, prindërit e saj dhanë një deklaratë të rreme për identitetin e tyre. S.A. e identifikon veten si shqiptare. Ajo dhe fëmijët e saj flasin shqip. Ajo nuk e kujton kohën e jetesës në Gjermani sepse prindërit e saj u kthyen në Shqipëri kur ajo ishte ende fëmijë. Babai i saj tani ka vdekur. Nëna e saj është gjallë dhe është shtetase shqiptare e regjistruar dhe e pajisur me dokumentacion për identitetin. S.A. u paraqit në zyrën e gjendjes civile ku ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme që të regjistrohej bazuar në dokumentin që prindërit e saj i kishin dhënë - një certifikatë lindjeje të lëshuar nga autoritetet gjermane. Zyra e Gjendjes civile refuzoi regjistrimin duke i komunikuar fillimisht se S.A. ishte madhore dhe duhet të aplikonte për nën-shtetësinë shqiptare përmes një procesi natyralizimi. Fëmijët e saj gjithashtu ishin të paregjistruar. S.A. i kishte lindur fëmijët e saj jashtë institucioneve spitalore dhe nuk dispononte asnjë dokument për lindjen e tyre.




TESTIMI I NDRYSHIMEVE LIGJORE NE PRAKTIKE

(TË DHËNA TË TLAS PËR VITIN 2019)

Gjatë vitit 2019, TLAS ka ndjekur dhe mbështetur zgjidhjen e 530 rasteve të regjistrimeve të lindjeve të fëmijëve nga mosha 1 deri në 18 vjec. Viti 2019 ka shërbyer edhe për testimin e zbatimit të ndryshimeve të ligjit të gjendjes civile nga të gjithë aktorët që kanë rol vendimtar në zbatimin e tyre si punonjësit e gjendjes civile, ata të mbrojtjes së fëmijëve, gjykatat, etj.

Avokatët e TLAS i janë referuar ndryshimeve të reja ligjore dhe akteve nenligjore në zbatim të tij për 221 raste:

- 47 raste regjistrimi të lindjeve të fëmijëve në zbatim të nenit 38/1 të ligjit të ndryshuar janë zgjidhur me gjykatë;
- 95 raste regjistrimi lindje të fëmijëve pa emër në dokumentin e lindjes, janë zgjidhur referuar Udhëzimit 286, datë 11.03.2019;
- 79 raste regjistrimi lindje të fëmijëve janë zgjidhur në bashkëpunim me NJMF-të, referuar Udhëzimit 284, datë 11.03.2019;



Model Kërkese e përdorur nga avokatët e TLAS për gjykimet me objekt "vërtetimi i faktit të lindjes nëpërmjet gjykatës për shkak të aktlindjeve të pasaktë/paplotë të mbajtura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë":

KËRKESË

DREJTUAR: *GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR* _____

KËRKUES: 1-Emër _____ Mbiemër _____, atësia _____, amësia _____, data e datëlindjes ____/____/____, lindur ne Leëisham, Angli dhe banuese Bashkinë _____; me adresë kontakti Sherbimi Ligjor Falas, Bulevardi "Bajram Curri", P. "Agimi", shk. 18, ap. 322, Tiranë, cel. 0692093731.

2. Emër _____ Mbiemër _____, atësia _____, amësia _____, e datëlindjes ____/____/____, lindur dhe banuese Bashkinë _____; me adresë kontakti Sherbimi Ligjor Falas, Bulevardi "Bajram Curri", P. "Agimi", shk. 18, ap. 322, Tiranë, cel. 0692093731.

PERSON I INTERESUAR: Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë _____.

OBJEKTI: Vërtetimin e faktit juridik të lindjes së E. S., e gjinisë femër, e lindur më datë _____._____._____, ne Lewisham, Angli, nga prindërit _____ e _____, me numër personal _____, me numër personal _____, me shtetësi shqiptare.

BAZA LIGJORE

Neni 54, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
Neni 38 /1, i Ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për

gjendjen civile”, i ndryshuar ;
Neni 8, i Ligji nr 18/2017 « Për të drejtat dhe mbrojtjen e
fëmijës »,
Nenet 388, e vijues të K.Pr.Civile ;
Kodi i Familjes ; Konventa për të drejtat e fëmijëve ;

I/e nderuar Z./Znj. Gjyqtar/e,

Rrethanat e faktit:

_____ është e bija e kërkueses _____. Prindërit e saj, së bashku me dy, emigruan për në Angli. Pas shumë peripecish, pasi nëna e saj ishte shtatzënë, ata mbërritën në Angli më _____.

Që në muajin e parë të qëndrimit në Angli, kërkuesja solli në jetë vajzën e tyre, _____, e cila lindi më datë _____.

Në kohën kur ka lindur _____, prindërit e saj, nuk kishin dokumenta të rregullta qëndrimi në Angli. Gjatë qëndrimit në Angli, ata u deklaruan si shtetas Kosovarë, për të përfituar statusin e azilkerkuesit.

Pas 3-vitesh të qëndrimit në Angli, më datë _____, familjarisht u deportuan nga autoritet Angleze, për shkak se nuk iu miratua leja e qëndrimit.

Pas kthimit në Shqipëri kërkuesit kanë tentuar të regjistrojnë vajzën e tyre, në zyrën e gjendjes civile në _____, mirëpo, kërkesa e tyre është refuzuar se dokumenti nga shteti Anglez, nuk ishte i saktë në rubrikat që lidheshin me identitetin e prindërve. Konkretisht, në përbërësit e gjendjes civile, rubrika e “mbiemrit dhe e vendlindjes” tek të dhënat atësi & amësi , në zyrën e gjendjes civile në _____, ata rezultojnë me mbiemrin “S _____” dhe jo “P _____”, vendlindja e tyre ishte _____ dhe jo Kosovë. Për këtë arsye zyra e gjendjes civile nuk e ka pranuar aplikimin për regjistrim.

Në këto rrethana, që prej lindjes kërkuesja _____, (20-vjeçare), ka mbetur e pa regjistruar dhe për pasojë ajo është dhe pa shtetësi.

E ndodhur në këto kushte, kërkuesja i drejtohet kësaj gjykate, për të kërkuar vërtetimin e faktit juridik të lindjes së saj, _____, nga prindërit _____ dhe _____, meshtetësi shqiptare.

Faktin e lindjes së _____, nga kerkuesja _____ dhe _____, vërtetohet prej provave shkresore indirekte bashkalidhur kësaj kërkesë, siç janë dokumentacioni që disponon nga Anglia (Çertifikata e lindjes me të dhëna të pasakta) , vërtetimi i shkollës tetëvjeçare dhe të mesme, si dhe **“RAPORT EKSPERTIMI TESTI I AMËSISË”** i datës ____ . ____ . 2019.

Analiza Ligjore:

E ndodhur përpara këtyre fakteve si dhe **Referuar dhe ligjit te posaçëm të gjendjes civile: Nenit 38/1**, të ligjit nr. 10129 date 11.05.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar i cili parashikon konkretisht:

Akti i lindjes i lëshuar jashtë vendit:

“Në rastet kur akti i lindjes i hartuar në një shtet tjetër ka të dhëna të paplota ose të pasakta, gjykata bën vërtetimin e faktit juridik të lindjes, me qëllim rregjistrimin në zyrat e gjendjes civile.

Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të lindjes mund ta paraqisin subjektet e parashikuara në nenin 40 të këtij ligji.

Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor në të cilin kanë vëndbanimin prindërit e fëmijës për të cilin kërkohet regjistrimi.

Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për vërtetimin e faktit juridik të lindjes brenda 45 ditësh nga data e depozitimit të kërkesës duke thirrur me cilësinë e personit të interesuar zyrën e gjendjes civile.

Nëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ushtrohet ankim, gjykata e apelit shqyrton ankimin, në dhomë këshillimi, brenda 30 ditësh nga data e depozitimit të tij”.

Gjithashtu referuar dhe nenit 388, të Kodit të Procedures Civile

“Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe **nuk mund të bëhet përsëri** ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, **personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.**

Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuesi.

Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni””.

Ligji Nr. 18/2017 “Per te drejtat dhe mbrojtjen e femijeve”

Neni 8

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin.

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:

- a) të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
- b) të ketë një emër;
- c) të fitojë shtetësinë;
- ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur.

2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.

3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën

e originës. Ndhima mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:

- a) gjetjen e prindërve;
- b) gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkues, me qëllim bashkimin familjar;
- c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.

4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.

5. Nëse nuk është i mundur përcaktimi i identitetit të një fëmije të gjetur ose të braktisur në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor ose identiteti i prindërve të fëmijës, punonjësi i strukturës së mbrojtjes së fëmijës, kryesisht ose pas marrjes së mendimit të strukturave përgjegjëse të shërbimeve sociale, cakton menjëherë një ose disa punonjës të institucionit ku është gjetur ose braktisur fëmija, për t'u kujdesur për fëmijën deri në marrjen e masave të nevojshme, sipas këtij ligji.

6. Kur fëmija braktiset nga nëna në maternitetet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, personeli social dhe mjekësor i tyre, brenda 24 orëve nga zhdukja e nënës, njofton me telefon dhe me shkrim njësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor dhe policinë, në të njëjtën kohë e mënyrë. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor, në bashkëpunim me punonjësin e policisë, përgatit raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Nëse gjendja shëndetësore e fëmijës është e mirë, bazuar në raportin e hartuar, njësia e mbrojtjes së fëmijës, pranë pushtetit vendor, merr masa për vendosjen e fëmijës, përkujdesje alternative, sipas nenit 57 të këtij ligji.

7. Në raste se identifikohet njeri nga prindërit, njesia për mbrojtjen e fëmijëve vendor ofron këshillim, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e fëmijës pranë familjes biologjike dhe lëshimin e certifikatës së lindjes. Nëse nëna nuk identifikohet pas hetimit të policisë, punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ka lindur fëmija, përgatit dosjen që përmban aktin e lindjes, raportin e përgatitur, sipas pikës 6, të këtij neni,

vendimin për masën e mbrojtjes së fëmijës dhe informacionin e dërguar nga policia për rezultatin e hetimeve të kryera.

8. Institucionet e kujdesit shëndetësor, të shërbimit social, shërbimet rezidenciale, si dhe të gjithë personat juridikë e fizikë që identifikojnë gra shtatzëna ose fëmijë që nuk kanë dokumente identifikimi, njoftojnë me shkrim punonjësën e njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ushtrojnë aktivitetin, i cili, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të pushtetit vendor, ndërmerr veprime konkrete për përcaktimin e identitetit të gruas shtatzënë ose të fëmijës.

9. Rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor, parashikohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Duhet nënvizuar se i gjithë legjislacioni vendas dhe i huaj, ka qenë dhe mbetet i ndjeshëm lidhur me të drejtat dhe garancitë e fëmijeve.

Kështu në nenin 2 të “Kodit Familjes” është ligjruar se:

“Prindërit, organet kompetente dhe Gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës”.

Veç sa më sipër, në të njëjtën frymë duhen konsideruar edhe akte të tilla si , **“Konventa për të drejtat e fëmijës”**, ku në nenin 8 te saj, janë përcaktuar qartazi detyrime për shtetet;

“1. Shtetet palë marrin përsipër respektimin e të drejtës së fëmijës, **për të ruajtur identitetin e tij**, duke përfshirë këtu shtetësinë, emrin e lidhjet familjare që njihen me ligj, pa ndonjë ndërhyrje të paligjshme”.

Dhe se

“2. Në qoftë se **një fëmije i mohohen** në mënyrë të paligjshme disa ose të gjitha **elementet e identitetit të tij**, shtetet palë i japin atij ndihmë dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij, të rivendoset shpejt”.

Duke qenë se kërkuesit, e kanë të pamundur të bëjnë regjistrimin e vajzës në zyrën e gjendjes civile të Bashkisë _____, për shkak se dokumentacioni që vërteton lindjen për femijën e tyre ka pasaktësi në rubrikat që lidhen me identitetin e prindërve, janë të plota kërkesat e nenit 388 të Kodit të procedurës Civile për korigjimin e këtyre pasaktësive.

Konkluzioni:

Në kushtet që provohet fakti i pretenduar nga kërkuesit për lindjen e kërkueses _____ nga prindërit _____ dhe _____, kërkohet të vendoset sipas objektit të kërkesës;

“Vërtetimin e faktit juridik të lindjes të kërkueses _____, e gjinisë femër, e lindur më datë _____._____._____, ne Lewisham, Angli, nga prindrit _____, me numër personal _____ & _____, me numër personal _____, me shtetësi shqiptare.

Bashkëlidhur kërkesës ndodhen këto prova shkresore:

- *Fotokopja e fletës regjistrat themeltar;*
- *Përgjigja refuzuese me shkrim nga gjendja civile,*
- *Çertifikata familjare;*
- *Fotokopjen e letërnjoftimit të prindërve*
- *Vërtetimet e shkollës;*
- *Çertifikatë lindje nga Anglia;*
- *Raport ekspertimi testi i Amësisë*

KËRKUES

Emër _____ Mbiemër _____

Pjesë të dispozitave të Ligjit Nr. 10 129, datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile" (i ndryshuar)

LIGJ

Nr. 10 129, datë 11.5.2009

"PËR GJENDJEN CIVILE" i ndryshuar me:

**Vendimin nr.52 datë 1.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese
Ligjin nr.6/2012, nr. 135/2013, nr. 134/2016 dhe nr. 69/2018**

Neni 27

Aktet për lindjet, martesat e vdekjet

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

ndryshuar pika 3 me ligjin nr.69/2018)

1. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht.

2. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahen në zyrën e gjendjes civile në njësi administrative, ku ato janë të regjistruar ose ku ka ndodhur lindja apo vdekja. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

"3. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes, për shtetasit shqiptarë, për shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, me banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile i shteteve të huaja ose nga përfaqësitë tona diplomatike apo konsullore atje, përcillen në zyrat e gjendjes civile përkatëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës, nga vetë i interesuari ose nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile."

Neni 36
“Plotësimet dhe korrigjimet në Regjistrin Kombëtar”
(ligji nr. 69, date 11.10.2018)

Kur në Regjistrin Kombëtar vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin, kur:

- a) përbërësi figuron në librat e akteve, në regjistrat themeltarë të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur, me ndryshim të vendbanimit, për çdo shkak;
 - b) i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit;
 - c) vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykate.
- ç) **“Për korrigjimin si gabim të provuar material të rubrikës së emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, ndiqet procedura e parashikuar në nenin 57/7 e vijues të këtij ligji.”**

Neni 38
Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.

2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.

3. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes.

“Neni 38/1

Akti i lindjes i lëshuar jashtë vendit

1. Në rastet kur akti i lindjes i lëshuar në një shtet tjetër ka të dhëna të paplota ose të pasakta, gjykata bën vërtetimin e faktit juridik të lindjes, me qëllim regjistrimin në zyrat e gjendjes civile.
2. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të lindjes mund ta paraqesin subjektet e parashikuara në nenin 40 të këtij ligji.
3. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në të cilin kanë vendbanimin prindi ose prindërit e fëmijës për të cilin kërkohet regjistrimi.
4. Gjkata që shqyrton çështjen për vërtetimin e faktit juridik të lindjes, merr vendim brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, duke thirrur, me cilësinë e personit të interesuar, zyrën e gjendjes civile.
5. Nëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ushtrohet ankim, gjykata e apelit shqyrton ankimin, në dhomë këshillimi, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij.”

Neni 40

Deklarimi i lindjes

(Ligji nr. 69, date 11.10.2018)

1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.
2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga e **njesisë e mbrojtjes së fëmijëve**, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.

“3. Nëse deklarimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga lindja, nga personat e përcaktuar në pikën 1, deklarimi kryhet nga subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.

Neni 41 Regjistrimi i lindjes

(shfuqizuar pika 3 dhe ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; ligji nr. 69, date 11.10.2018)

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.

2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.

3. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi i lindjes mund të bëhet edhe në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin ku ka ndodhur lindja.”

4. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Fondi për shpërblimin për regjistrimin e lindjes brenda afatit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4, të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit. Procedurat për përfitimin e shpërblimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.”

“Neni 41/1

Raportimi dhe regjistrimi i lindjeve me procedurë të veçantë

(shtuar si nen me Ligjin nr. 69/2018)

1. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore, publike dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që, për çdo lindje të ndodhur pranë institucioneve të tyre, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, dokumentacionin/njoftimet përkatëse. Ky proces kryhet çdo ditë të hënë, për javën pararendëse. Modalitetet, lloji i dokumentacionit, forma dhe mënyra e komunikimit ndërmjet këtyre institucioneve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës që mbulojnë institucionete lartpërmendura.

2. Për çdo lindje të raportuar, sipas pikës 1, të këtij neni, zyra përkatëse e gjendjes civile pasqyron lindjen në regjistrin e përkohshëm.

Ministri përgjegjës për gjendjen civile përcakton me udhëzim rregulla të hollësishme për krijimin dhe administrimin e regjistrit të përkohshëm të lindjeve të raportuara.

3. Nëse regjistrimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga data e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile informon njësinë për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë vendore, e cila ndërmer veprimet konkrete për vlerësimin e situatës dhe regjistrimin e lindjes në zyrën e gjendjes civile. Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”

Neni 45

Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes

(Ndryshuar me ligjin nr. 69/2018)

1. Në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile pasqyrohen të dhënat sikurse janë e për aq sa përmban akti i lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme

2. Kur në aktin e lindjes është caktuar emri i përkohshëm apo kombësia, mund të bëhet shënimi, në çdo kohë, kundrejt deklaramit e nënshkrimit të përbashkët të prindërve ose me vendim gjykatë. Kur fëmija bëhet madhor, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm prej tij, përveç rastit kur i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

3. Plotësimi i të dhënave në Regjistrin Kombëtar, kur në aktin e lindjes ka rubrika të paplotësuar, bëhet, sipas rastit, me vendim gjykatë.

“3/a. Kur në aktin e lindjes të mbajtur jashtë vendit është e paplotësuar rubrika e emrit, plotësimi i saj bëhet në përputhje me procedurën administrative, të përcaktuar me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI
UDHËZIM
NR. 284, DATË 11.03. 2019**

**PËR
PROCEDURËN E MBAJTJES SË AKTIT TË LINDJES TË FËMI-
JËVE, NË RASTET KUR NUK ËSHTË RESPEKTUAR AFATI KO-
HOR I REGJISTRIMIT TË TYRE, BRENDË 60 DITËVE NGA DATA E
LINDJES**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 40, pika 3 dhe të nenit 41/1, të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

U D H Ë Z O J:

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme dhe procedurës administrative, që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki, në rastin kur nuk është bërë regjistrimi i fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 (në vijim Regjistri Kombëtar), brenda 60 ditëve, nga data e lindjes.

2. Kur nëpunësi i gjendjes civile konstaton se, nuk është kryer regjistrimi i fëmijës së lindur në Regjistrin Kombëtar, brenda 60 ditëve nga data e lindjes, njofton me shkresë zyrtare për këtë fakt, drejtuesin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin përkatës.

3. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, dërgon për trajtim shkresën pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, brenda 24 orëve nga paraqitja e saj. Në rastin e Bashkisë Tiranë, shkresa i dërgohet çdo njësie administrative, që ka njësi të veçantë të mbrojtjes së fëmijës.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, (në vijim punonjësi për mbrojtjen e fëmijës) administron shkresën dhe dokumentacionin e dërguar nga nëpunësi i gjendjes civile, si dhe çdo akt tjetër që nxjerr sipas këtij udhëzimi, duke krijuar dosje të veçantë për çdo fëmijë të paregjistruar.

5. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga nëpunësi i gjendjes civile, i cili duhet të përgjigjet brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës.

6. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, kontakton menjëherë me prindin/prindërit e fëmijës të paregjistruar në Regjistrin Kombëtar dhe në pamundësi të kontaktit me ta, kontakton me çdo person, që mund të deklarojë lindjen e fëmijës, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 40, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar dhe në pamundësi për të kontaktuar edhe me këta persona, i drejtohet subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të po këtij neni.

7. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, informon personin e kontaktit përcaktuar në pikën 6, të këtij udhëzimi:

d) për detyrimin për regjistrimin e fëmijës në gjendjen civile sipas legjislacionit në fuqi;

e) për përfitimet dhe domosdoshmërinë e regjistrimit të fëmijës;

f) se në rast se fëmija nuk regjistrohet brenda 60 ditëve nga data e lindjes, procedura e regjistrimit të fëmijës kryhet nga njësia për mbrojtjen e fëmijës.

Për takimin e zhvilluar mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të pranishmit dhe nëse refuzohet nënshkrimi, evidentohet ky fakt. Procesverbali bëhet pjesë e dosjes së fëmijës së paregjistruar.

8. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, cakton një afat prej 10 ditësh nga zhvillimi i takimit sipas pikës 7, me qëllim që personi i kontaktuar sipas pikës 6, të regjistrojë fëmijën në Regjistrin Kombëtar.

9. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 8, të këtij udhëzimi, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, verifikon në zyrën e gjendjes civile, nëse janë paraqitur personat sipas pikës 6, të këtij udhëzimi, për mbajtjen e aktit të lindjes dhe sipas rastit, kryen veprimet e mëposhtme:

a) nëse fëmija është regjistruar, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton raportin përmbledhës për veprimet e kryera, pjesë e të cilit është edhe konkluzioni për mbylljen e dosjes;

b) nëse fëmija nuk është regjistruar, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me nëpunësin e zyrës së gjendjes civile, përcaktojnë emrin e fëmijës, hartojnë aktin e lindjes dhe e nënshkruajnë atë.

Emri i fëmijës, së regjistruar sipas kësaj procedure, është “i përkohshëm” dhe mund të ndryshojë vetëm me kërkesë të personave dhe sipas procedurës, të përcaktuar sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, për këtë rubrikë dhe vetëm në këto raste.

10. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës njofton zyrtarisht personin me të cilin ka kontaktuar, sipas pikës 6, të këtij udhëzimi, për regjistrimin e fëmijës, modalitetet e regjistrimit, si dhe i dërgon kopje të aktit të lindjes.

11. Dokumentacioni për regjistrimin e fëmijës, sipas procedurës së parashikuar në këtë udhëzim, hartohet dhe protokollohet në dy kopje, një kopje pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe një kopje në zyrën e gjendjes civile ku është bërë regjistrimi.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Sandër LLESHAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRI I BRENDSHËM MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 285, datë 11/03/ 2019

PËR

KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT TË PËRKOHSHËM PËR LINDJET E RAPORTUARA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 41/1, të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

U D H Ë Z O J:

1. Regjistri i Përkohshëm në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 41/1 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, është një modul elektronik, në të cilin do të pasqyrohen të dhënat vetëm për rastet e lindjeve të raportuara dhe të paregjistruara në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Regjistri i Përkohshëm, këtu e në vijim i përmendur si “moduli”, do të jetë i integruar në të njëjtin mjedis ku është i integruar Rregjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, pra portal web.

3. Mirëmbajtja dhe zhvillimi i këtij moduli do të realizohet nga subjekti që mirëmban dhe zhvillon portalin ëeb të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është institucioni përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e të dhënave që ruhen në këtë modul. Përditësimi i të dhënave bëhet nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile të një-sive administrative.

5. Në këtë modul pasqyrohen të dhënat për gjithë të lindurit e paregjistruar, të cilët prezumohet se kanë shtetësinë shqiptare, pavarësisht faktit se kanë lindur brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se kanë lindur në institucione spitalore publike/ jo publike apo jashtë tyre, sipas përcak-timeve të pikës 6, të këtij udhëzimi.

6. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në njësinë administrative pasqyron në këtë modul të dhënat:

a) për të gjithë fëmijët e lindur në institucione spitalore, për të cilët ka marrë njoftimin prej këtyre institucioneve dhe ndërkohë personat që kanë të drejtën dhe detyrimin e deklarimit nuk janë paraqitur para nëpunësit për të mbajtur aktin e lindjes;

b) për të gjithë të lindurit, për të cilët nëpunësi i gjendjes civile, pasi është njo-hur me kërkesën e deklaruesit konstaton se nuk mund të mbajë akt lindje, për shkak se dokumenti “asistencë në lindje” ose raporti mjeksor është me pasak-tësi ose ka rubrika të paplotësuara;

c) për të gjitha rastet kur deklaruesi nuk ka dokument që vërteton lindjen;

ç) për rastet kur akti i lindjes i mbajtur jashtë vendit ka pasaktësi ose është i paplotë në rubrikat e tij;

d) si dhe çdo rast tjetër që konstatohet i paregjistruar, për të cilin nuk mund të mbahet akt lindje në momentin e konstatimit/deklarimit.

7. Të dhënat e pasqyruara në modul, do të qëndrojnë aty, deri sa rasti të zgjidhet. Zgjidhja mund të jetë nëpërmjet rrugës gjyqësore ose rrugës adimistrative dhe

nëpunësi të ketë mundësinë e mbajtjes së aktit të lindjes, ose të pasqyrimit të aktit të lindjes të mbajtur jashtë vendit.

8. Të dhënat që përmban moduli janë si më poshtë:

- emri/mbiemri i personit të pa regjistruar;
- emri i babait & numri personal i babait, (nëse ka);
- emri i nënës & numri personal i nënës;
- datëlindja;
- vendlindja;
- gjinia;
- adresa e banimit dhe numri i kontaktit;
- Arsyeja e mosregjistrimit;
- Dokumentat e paraqitura që mund të jenë:
 - i) Raportimi nga institucionet e shërbimit spitalor shtetëror, publik ose privat;
 - ii) Raportime nga institucione të ndryshme;
 - iii) Raportim nga vetë shtetasit;
- Data e regjistrimit në Regjistrin e Përkohshëm;
- Data e zgjidhjes së rastit/regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

9. Moduli përmban edhe opsionin e njoftimit të nëpunësit të gjendjes civile, në rastin kur kalohet afati 60 ditor, nga data e lindjes.

Me kalimin e afatit 60 ditor të përmendur më lart, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, kryen këto veprime:

a) kontrollon nëse të dhënat e regjistruara për lindjen dhe/ose regjistrimin, janë regjistruar përfundimisht në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Në rast se është bërë regjistrimi i të dhënave për personin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile atëherë nëpunësi i gjendjes civile vendos në modul shënimin, “E zgjidhur”.

b) në rast se nëpunësi i gjendjes civile konstaton se, fëmija nuk është regjistruar ende në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile atëherë kryen veprimet e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm, “Për procedurën e mbajtjes

së aktit të lindjes të fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes”.

10. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, në bazë të të dhënave të modulit lëshon vërtetim, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij. Vërtetimi i lëshuar nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, i jepet të interesuarit për plotësimin e të drejtave të tij për arsim, trajtim shëndetësor ose përfitimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, apo në çdo aspekt tjetër për të cilin ka interes të ligjshëm.

11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nëpunësit e zyrave të gjendjes civile për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Sandër LLESHAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA _____
NJESIA ADMINISTRATIVE _____,
ZYRA E GJENDJES CIVILE

Nr. _____, prot,

Datë _____, _____, _____

VËRTETIM

(Emri/mbiemri i personit) _____

datëlindje, _____,

vendlindje, _____,

emri i babait, _____, numër personal dhe,

emri i nënës, _____, numër personal,

është i regjistruar në Regjistrin e Përkohshëm të Zyrës së Gjendjes Civile të
Njesisë Administrative _____.

Ky dokument lëshohet për efekt _____

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

Emër / mbiemër vula

Shënim:

Ky vërtetim ka burimin dhe gjenerohet nga Rregjistri i Përkohshëm që mbahet nga zyra e Gjendjes Civile.

Ky vërtetim ka vlerë juridike dhe lejohet të përdoret deri në momentin që personi rregjistrohet në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Ky vërtetim është i vlefshëm vetëm për realizimin e të drejtave të ligjshme të personit të tilla si arsimin, përkujdesje shoqërore, trajtim shëndëtsor, etj.

Të dhënat që përmban ky Vërtetim nuk janë dokument identiteti për personin dhe të dhënat e pasqyrura janë vetëm në bazë të deklarimeve të bëra nga vetë personi/kërkuesi në momentin e regjistrimit në Regjistrin e Përkohshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 286, datë 11/03/ 2019

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE QË ZBA- TOHET NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE KUR NË AKTIN E LINDJES MBAJTUR JASHTË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ËSHTË E PAPLOTËSUAR RUBRIKA E EMRIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 45, pika 3/a të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

U D H Ë Z O J :

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurës administrative, që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile, për regjistrimin e fëmijëve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në rastet kur në aktin e lindjes së tyre të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është e paplotësuar vetëm rubrika e emrit të fëmijës.
2. Kërkesa për pasqyrimin e të dhënave të aktit të lindjes, të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e paplotësuar të emrit, paraqitet nga të dy prindërit/ prindi, ose nga çdo person i parashikuar sipas ligjit

“Për gjendjen civile”, i ndryshuar. Kërkesa paraqitet në zyrën e gjendjes civile ku kanë vendbanimin prindërit/prindi.

3. Personi deklarues, sipas pikës 2, paraqet në zyrën e gjendjes civile, ku kanë vendbanimin:

- a) kërkesën e nënshkruar prej tyre, sipas Formularit 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij;
- b) dokumentin original të aktit të lindjes, i cili është në formën e kërkuar nga ligji me vulën “APOSTILLE”, por që ka të paplotësuar rubrikën e emrit;
- c) deklaratën me shkrim për emrin që do të mbajë fëmija, sipas Formularit 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij, duke përjashtuar emrat që janë parashikuar nga aktet nënligjore në fuqi, si të papërshtatshëm për t’u mbajtur;
- ç) kopje të letërnjoftimit;
- d) prokurën e posaçme, kur nuk është asnjë nga prindërit deklarues.

4. Nëpunësi i gjendjes civile, pasi ka administruar dokumentacionin sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, regjistron fëmijën në Regjistrin Kombëtar me emrin që kanë deklaruar deklaruesit sipas Formularit nr. 2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Nëpunësi i gjendjes civile në rubrikën përshkrimi shënon: *“Regjistrim lindje sipas aktit nr. __, datë, __/__/__, mbajtur në zyrën e gjendjes civile _____ dhe deklaratës së vendosjes së emrit nr. __ datë __/__/__”*

5. Në rastin, kur akti i lindjes i mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ka rubrikën e emrit të paplotësuar dhe nuk përmban vulën “APOSTILLE”, atëherë nëpunësi:

- a) këshillon deklaruesin për procedurën ligjore të vendosjes së vulës “APOSTILLE” në aktin e lindjes, kur ai shprehet se do ta kryejë vetë këtë procedurë;

b) kur i interesuari është në pamundësi ta kryejë vetë këtë procedurë, nëpunësi i gjendjes civile duhet të:

i) hartojë një procesverbal në të cilin provon se i interesuari ka de pozituar në zyrën e gjendjes civile aktin e lindjes së fëmijës, të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e emrit të paplotësuar;

ii) sqarojë deklaruesin për tarifën financiare që duhet të paguajë për këtë shërbim dhe mënyrën e arkëtimit të saj.

Nëpunësi i gjendjes civile, aktin e lindjes të mbajtur me procesverbal, si dhe kopjen e mandatit të arkëtimit në bankë, të tarifës së përcaktuar sipas pikës 6, e dërgon me shkresë zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, brenda 48 orëve, dhe ky i fundit e përcjell tek strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, brenda 48 orëve nga data e marrjes. Në këtë rast, deklaruesit i jepet një kopje e procesverbalit, ku të jenë shënuar edhe kontaktet e nevojshme të tyre, së bashku me adresën e tij.

6. Deklaruesit kryejnë pagesën e tarifës së përcaktuar, në numrin e llogarisë bankare të ambasadës apo konsullatës përkatëse, ku do të dërgohet akti për vendosjen e vulës “APOSTILLE”. Këto numra llogarie publikohen pranë çdo zyre të gjendjes civile.

7. Në rast të mosmbajtjes së aktit të lindjes sipas pikës 5 të këtij udhëzimi, nëpunësi i gjendjes civile i regjistron të dhënat e fëmijës në Regjistrin e Përkohshëm, sipas procedurës së parashikuar në udhëzimin përkatës.

8. Në rastin e parashikuar në pikën 5, (a) të këtij udhëzimi, kur deklaruesi, risjell në zyrën e gjendjes civile, aktin e lindjes së mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e emrit të paplotësuar në të cilën është vendosur vula “APOSTILLE”, nëpunësi i gjendjes civile kryen procedurën e parashikuar në pikën 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

9. Në rastin e parashikuar në pikën 5, (b), procedura e regjistrimit fillon pasi mbërrin zyrtarisht në zyrën e gjendjes civile që e dërgoi, akti i lindjes i pajisur me vulën “APOSTILLE”. Pasi merr aktin në formën e kërkuar, nëpunësi i gjendjes civile njofton deklaruesin dhe pas paraqitjes së tij fillon procedurën e parashikuar në pikën 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

10. Pas përfundimit të kësaj procedure, nëpunësi i gjendjes civile pajis deklaruesin me certifikatën e lindjes së fëmijës së regjistruar.

11. Fashikulli i krijuar nga kjo procedurë është me afat ruajtje të përhershme.

12. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile dhe misionet diplomatike e postet konsullore të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Sandër LLESHAJ

FORMULARI 1

KËRKESË

Drejtuar: Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë Administrative _____

KËRKUES: Z./Znj. _____, i biri _____
dhe _____, e datëlindjes _____, me
numër personal _____, banues në adresën:

cel _____ ose numër kontakti :

Lënda: Kërkesë për kryerjen e procedurës administrative për regjistrimin e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pasi në aktin e lindjes të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është e paplotësuar rubrika e emrit të personit.

Unë i/e quajtura _____, paraqes këtë kërkesë, pranë Zyrës së Gjendjes Civile _____, me anë të së cilës kërkoj, plotësimin e rubrikës së emrit të fëmijës, në aktin e lindjes të mbajtur në _____, sipas deklaratës bashkëlidhur.

Bashkëlidhur paraqes edhe aktin e lindjes original, të mbajtur në shtetin _____.

KËRKUESI

Datë: _____

Nr. _____ Prot.,

Datë _____

DEKLARATË E PËRBASHKËT E VENDOSJES SË EMRIT

Sot, më datë ____ / ____ / _____, unë i nënshkruari,
Z./Znj. _____, lindur në _____, më
datë ____ / ____ / _____, numër _____ personal _____, banues
në _____

në cilësinë e _____, deklaroj se:
fëmija i gjinisë _____, i lindur në _____, më datë
____ / ____ / _____, nga prindërit _____ dhe _____, do të
quhet " _____".

E lëshojmë këtë deklaratë, pasi akti i lindjes me nr. _____, datë
____ / ____ / _____, i mbajtur pranë zyrës së gjendjes civile
_____, nuk e ka të pasqyruar rubrikën e emrit të fëmijës.

Unë nëpunësi i gjendjes civile, bazuar në pikën 3/a, të nenit 45, të Ligjit Nr. 10129, datë
11.05.2009, "Për gjendjen civile", i ndryshuar, si dhe mbështetur në deklarinim e bërë nga
_____ dhe pasi verifikova dokumentat përkatëse, konstatova se ato janë në
përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe në vullnetin e lirë dhe të pavarur të deklartuesit.
Për këtë arsye unë e nënshkruaj atë, duke i dhënë forcën e nevojshme ligjore.

Deklaruesi

Nëpunësi i Gjendjes Civile

Përfaqësuesi me prokurë _____

*Bashkëlidhur kësaj deklarate vendoset fotokopja e letërnjoftimit të deklartuesit; kërkesa e tij;
akti i lindjes nr. _____, datë _____, i mbajtur nga Zyra e Gjendjes
Civile e _____.*

Ky fashikull është me afat ruatje përhershme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**

Nr. 7219 Prot. Datë 24. 12. 2018

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 10432/2 Prot. Datë 28. 12. 2018

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 870. Datë 24.12.2018

PËR

**PËRCAKTIMIN E VEPRIMEVE DHE PROCEDURËS QË KRYEJNË
NËPUNËSIT E ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE DHE PERSONI I
AUTORIZUAR PRANË INSTITUCIONIT TË SHËRBIMIT SPIT-
ALOR, PËR PËRFITIMIN E MASËS SË NDIHMËS SË MENJËHER-
SHME FINANCIARE PËR NËNAT ME FOSH NJA TË
PORSALINDURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1 dhe 2 të nenit Nr. 41/1, të Ligjit Nr.10129, datë 11.05.2009, “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar, dhe të pikës 3, të Vendimit Nr.740, datë 12.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurës së dhënies së tij”, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Brendshëm,

UDHËZOJMË:

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i veprimeve, që do të kryejnë nëpunësit e gjendjes civile dhe nëpunësit e institucioneve të shërbimit spitalor ku ndodh lindja, në lidhje me pajisjen me dokumentet e nevojshme, mbi përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miraton formatin e “Certifikatës së asistencës së lindjes”, e cila mbahet në dy kopje dhe është e njëjtë në të gjithë institucionet e shërbimit spitalor publik.

3. Institucioni i shërbimit spitalor ku ndodh lindja pajis prindin/prindërit me “Certifikatë asistencë në lindje”, pas lindjes së fëmijës. Prindi/prindërit e pajisur me “Certifikatën Asistencë në Lindje”, e cila mbahet në dy kopje, paraqiten pranë nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile të ngarkuar me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor, për mbajtjen e aktit të lindjes së fëmijës. Institucioni i shërbimit spitalor kopjen e dytë ia përcjellë nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile pranë tyre. Oraret e pajisjes së prindit me “Certifikatën Asistencë në Lindje” janë nga ora 9:00 deri në 13:00.

4. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, në prezencë të prindit/prindërve, administron dokumentin “Certifikatë Asistencë në Lindje”, si dhe dokumentin e identifikimit të tij/tyre.

5. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar dokumentat e listuara sipas pikës 4 të këtij Udhëzimi, kryen verifikimin në Regjistrin Kombëtar dhe mban aktin e lindjes, sipas procedurës së përcaktuar për këtë qëllim. Pas mbajtjes së aktit të lindjes printon “Certifikatën nga akti i lindjes”, për fëmijën.

6. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pas mbajtjes së aktit të lindjes, verifikon përbërjen familjare, numrin e fëmijëve dhe pasi bien dakord prindi/prindërit mbi numrin e pjestarëve të familjes, printon certifikatën familjare.

7. Në rastet kur prindi/prindërit kanë pretendime mbi numrin e pjestarëve të familjes, nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile kryen verifikimet e nevojshme deri në zgjidhjen përfundimtare.

8. Certifikatat e plotësuara dhe lëshuara sipas pikës 5 të këtij Udhëzimi, kanë shënimin “Lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare” (Bonusi).

9. Prindi/prindërit pasi janë pajisur me certifikatat e mësipërme, paraqiten pranë nëpunësit të autorizuar nga institucioni i shërbimit spitalor ku ka ndodhur lindja, për tërheqjen e çekut. Vlera e çekut të lëshuar nga nëpunësi i institucionit të shërbimit spitalor është:

- a.** Në masën 40 000 (dyzet mijë lekë) për lindjen e fëmijës së parë;
- b.** Në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë lekë) për lindjen e fëmijës së dytë;
- c.** Në masën 120 000 (njëqind e njëzetë mijë lekë) për lindjen e fëmijës së tretë dhe fëmijëve të tjerë në vijim;
- d.** Për nënat që linden binjakë masa e përfimit do të jetë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë lekë) për secilin fëmijë;
- e.** Për fëmijët që linden trinjakë dhe më shumë, masa e përfimit do të jetë në masën 120 000 (njëqind e njëzetë mijë lekë) për secilin fëmijë.

10. Në rastet kur prindi/prindërit nuk mbajnë aktin e lindjes së fëmijës në institucionin e shërbimit spitalor, personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor depoziton kopjen e certifikatës së asistencës së lindjes, nëpunësit të gjendjes civile i atashuar pranë këtij institucionipër verifikimin e pjesëtarëve të familjes. Nëpunësi i gjendjes civile i atashuar pranë spitalit lëshon certifikatën familjare të nënës dhe ia jep nëpunësit të autorizuar të institucionit spitalor, me qëllim përcaktimin e vlerës së ÇEK. Të gjitha veprimet e mësipërme bëhen në prani të prindi/prindërit.

11. Pas verifikimit nëpunësi i autorizuar i shërbimit spitalor plotëson dy çeqe. Çeku i parë do të jetë në vlerën:

- a.** 35 000 (tridhjetë e pesë mijë lekë) për lindjen e fëmijës së parë;
- b.** 75 000 (shtatë dhjetë e pesë mijë lekë) për lindjen e fëmijës së dytë;

- c. 115 000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë lekë) për lindjen e fëmijës së tretë dhe fëmijëve të tjerë në vijim;
- d. Për nënat që lindin binjakë masa e përfimit do të jetë në masën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë lekë) për secilin fëmijë;
- e. Për fëmijët që lindin trinjakë dhe më shumë, masa e përfitimit do të jetë në masën 115 000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë lekë) për secilin fëmijë.

Çeku i dytë do të jetë në masën prej 5 000 (pesë mijë lekë) dhe do të emetohet nga bankat pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar.

12. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile pasi mban aktet e lindjes për çdo ditë, bën bilancin javor dhe për çdo të hënë për javën pararendëse, për rastet që nuk kanë mbajtur akt lindje pranë shërbimit spitalor, grupon “Certifikatat asistencë në lindje”, sipas adresave të vendbanimit të nënës pas verifikimit në RK dhe ia përcjell protokollit të institucionit të shërbimit spitalor. Protokollit i institucionit të shërbimit spitalor ka detyrimin t’i përcjellë pranë zyrës së gjendjes civile përkatëse, brenda ditës.

13. Në rastin kur akti i lindjes nuk mbahet në institucionin e shërbimit spitalor, prindi/prindërit ose njëri nga personat e parashikuar nga ligji i shërbimit të gjendjes civile, për këtë qëllim, paraqiten pranë zyrës së gjendjes civile ku kanë vendbanimin.

14. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pas paraqitjes së deklaruësit, kryen veprimet sipas legjislacionit në fuqi dhe pajis me certifikatat e nevojshme deklaruësin.

15. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, të cilit i ka ardhur njoftimi “Certifikatë asistencë në lindje”, nga institucioni i shërbimit spitalor, kryen verifikimet edhe njëherë në RK dhe në rast se nuk është mbajtur akt lindje për këtë fëmijë, e regjistron atë te programi “Raste të paregjistruara”, në RK.

16. Në rastet kur lindja ka ndodhur në shërbimin spitalor privat të licensuar sipas legjislacionit në fuqi, prindi/prindërit pasi e regjistrojnë fëmijën në zyrën e gjendjes civile, pajisen me certifikatën personale nga akti i lindjes dhe famil-

jare me shënimin “Lindje në institucion privat (emri i institucionit), lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi)”, do të paraqiten pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tërheqjen e ÇEK-ut, sipas vlerave të përcaktuara të bëra në pikën 9, të këtij Udhëzimi.

17. Në rastet kur akti i lindjes është mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasqyron lindjen në RK, sipas procedurës. Nëpunësi pasi verifikon se lindja është pasqyruar sipas afateve ligjore pajis deklaruesin, me certifikatën personale e familjare me shënimin “Lindje jashtë shtetit, lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi)”. Prindi/Prindërit pas paisjes nga shërbimi i gjendjes civile me certifikatën personale e familjare me shënimin “Lindje jashtë shtetit, lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare” (Bonusi), do të paraqitet pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tërheqjen e ÇEK-ut, sipas vlerave të përcaktuara të bëra në pikën 9, të këtij Udhëzimi.

18. Në rast se deklarimi i aktit të lindjes të mbajtur jashtë vendit kryhet jashtë afatit 90 ditor, nëpunësi i gjendjes civile kryen pasqyrimin e lindjes në RK, por nuk pajis deklaruesin me certifikatat përkatëse “Për përfitim të ndihmës së menjëhershme financiare” (Bonus). Në këto raste prindi/prindërit nuk përfitojnë as pagesën prej 5 000 (pesë mijë) lekë.

19. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm, Nr.116, datë 12.04.2010, “Për procedurat e përfitimit të shpërblimit nga rregjistrimi i fëmijëve sipas Ligjit Nr.10129, datë 11.05.2009, “Për Gjendjen Civile”, shfuqizohet.

Ky Udhëzim hyn në fuqi më datë 01.01.2019 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ogerta MANASTIRLIU

Sandër LLESHAJ

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**

MINISTRIA E BRENDSHME



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VENDIM

Nr.288, datë 10.4.2020

PËR

PËRCAKTIMIN E MASËS DHE TË PROCEDURËS SË DHËNIES SË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE PËR FOSHNJAT E POR- SALINDURA DHE MËNYRËN E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET INSTI- TUCIONEVE TË SHËRBIMITSPITALOR DHE ATYRE TË GJENDJES CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. MASA E DHËNIES SË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE

1. Ndhima e menjëhershme financiare (Bonusi) për prindin/prindërit me foshnja të porsalindura është, si më poshtë vijon:

- a) Në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë për lindjen e foshnjës së parë;
- b) Në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për lindjen e foshnjës së dytë;
- c) Në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për lindjen e foshnjës së tretë dhe të foshnjave të tjera në vijim;
- ç) Për prindërit që sjellin në jetë dy foshnja të lindura njëherësh (binjakë), masa e përfitimit do të jetë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për secilën foshnjë;
- d) Për prindërit që sjellin në jetë më shumë se dy foshnja të lindura njëherësh

(trinjakë dhe më shumë), masa e përfitimit do të jetë në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për secilën foshnjë.

2. Në masën e ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi), të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfshihet edhe shpërblimi në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për regjistrimin e lindjes brenda afatit, të përcaktuar në pikën 4, të nenit 41, të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar.

II. PROCEDURA PËR DHËNIEN E NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE

1. Ndihmën e menjëhershme financiare (Bonusi), sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, e përfitojnë:

a) prindi/prindërit, shtetas shqiptarë për foshnja të lindura brenda ose jashtë vendit dhe të regjistruara sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile;

b) prindi/prindërit me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe vendosin t’i japin foshnjës shtetësi shqiptare, sipas ligjit për shtetësinë shqiptare dhe e regjistrojnë si shtetas shqiptar në Regjistrin e Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Nëpunësi i gjendjes civile, i atashuar pranë institucioneve të shërbimit spitalor ku kryhet lindja, kryen veprimet e verifikimit on-line të statusit të prindit dhe regjistron foshnjën e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010.

Pas regjistrimit kryen verifikimet e nevojshme për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi) sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.

3. Ndihma e menjëhershme financiare (Bonusi), sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, i jepet prindit/prindërve, menjëherë pas lëshimit të dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”, në përfundim të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Në rastin kur foshnja ndërron jetë pas lindjes, por për të është plotësuar nga ana e institucionit spitalor dokumenti “Certifikatë asistence në lindje”, prindi/prindërit përfitojnë ndihmën e menjëhershme financiare (bonusin) pasi të kryhet regjistrimi në RK-GJC, nga ana e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile dhe të lëshohet

dokumenti “Certifikatë nga akti i lindjes” dhe certifikata familjare sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.

4. Masa e ndihmës së menjëhershme financiare jepet në formën e një çeku, të emetuar në emër të prindit/prindërve, dhe ose sipas rasteve të përcaktuara në pikën 2, të kreut II, të këtij vendimi, dhe të pagueshëm:

a) 35 (tridhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”;

b) 75 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”;

c) 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”;

ç) Diferenca e mbetur prej 5 (pesë mijë) lekësh, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

5. Vlera e përcaktuar në çek tërhiqet në bankat e nivelit të dytë me të cilat Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

III. MËNYRA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE ATYRE TË GJENDJES CIVILE

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miraton formatin e dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”, e cila është e njëjtë në të gjitha institucionet e shërbimit spitalor publik dhe miraton formatin e shërbimit spitalor jopublik që ka vendosur vetë institucioni.

2. Institucioni i shërbimit spitalor publik ose jopublik ku ndodh lindja e foshnjës plotëson dokumentin “Certifikatë asistence në lindje” në dy kopje dhe pajis prindin/prindërit me një kopje të saj. Orari i pajisjes së prindit/prindërve me dokumentin “Certifikatë asistence në lindje” është nga ora 9:00 deri në 13:00, nga e hëna në të shtunë. Orari i nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile pranë shërbimit spitalor publik ose jopublik është nga ora 09:00-14:00, nga e hëna në të shtunë.

3. Prindi/prindërit e pajisur me dokumentin “Certifikatë asistence në lindje” paraqiten para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile, të ngarkuar me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor për mbajtjen e “Aktit të lindjes”, çdo ditë, nga e

hëna në të shtunë, nga ora 9:00 deri në 13:00. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, në prezencë të prindit/prindërve, administron dokumentin “Certifikatë asistence në lindje”, si dhe mjetin e identifikimit të tyre.

4. Kopja e dytë e dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”, së bashku me fotokopjen e dokumentit të identitetit të prindit/prindërve i jepet zyrtarisht (dorëzohet) me procesverbal nga personi i autorizuar i institucionit të shërbimit spitalor të nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, i ngarkuar me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor, në përfundim të çdo dite.

5. Për lindjet e ndodhura jashtë institucionit të shërbimit spitalor, si banesë, tren, anije etj. apo në çdo ambient tjetër që nuk është përmendur në këtë vendim personeli që asiston ose verifikon lindjen ka detyrimin të plotësojë dokumentin “Certifikatë asistence në lindje” e të pajisë me një kopje të saj prindin/prindërit dhe kopjen e dytë ta dorëzojë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e lindjes së foshnjës në zyrën e gjendjes civile në territorin ku ka ndodhur lindja.

6. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar dokumentet e listuara sipas pikave 4 dhe 5, të këtij kreu, kryen verifikimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, verifikon përbërjen familjare, numrin e foshnjave, dhe pasi bie dakord me prindin/prindërit mbi numrin e pjesëtarëve të familjes, printon certifikatën me gjendje familjare para mbajtjes së aktit të lindjes.

7. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile mban aktin e lindjes, në prezencë të prindit/prindërve, sipas procedurës së përcaktuar për këtë qëllim. Pas mbajtjes së aktit të lindjes printon certifikatën nga akti i lindjes, si dhe certifikatën familjare, duke pasqyruar në përbërjen familjare edhe foshnjën.

8. Në rastet kur prindi/prindërit kanë pretendime mbi numrin e anëtarëve të familjes, nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile kryen verifikimet e nevojshme deri në zgjidhjen përfundimtare.

9. Certifikatat e plotësuara dhe të lëshuara sipas pikës 8, të këtij kreu, kanë shënimin “Lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare” (Baby Bonus).

10. Prindi/prindërit pasi janë pajisur me certifikatat e sipërpërmendura, paraqiten pranë nëpunësit të autorizuar nga institucioni i shërbimit spitalor ku ka ndodhur lindja, për tërheqjen e çekut.

11. Në rastet kur prindi/prindërit nuk mbajnë aktin e lindjes së foshnjës në institucionin e shërbimit spitalor, personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor ia depoziton kopjen e dokumentit “Certifikatë asistence në lindje” nëpunësit të gjendjes civile të atashuar pranë këtij institucioni për verifikimin e pjesëtarëve të familjes. Nëpunësi i gjendjes civile i atashuar pranë shërbimit spitalor publik/jopublik lëshon certifikatën familjare të prindit/prindërve dhe ia jep nëpunësit të autorizuar të institucionit spitalor, me qëllim përcaktimin e vlerës së çekut. Të gjitha veprimet e sipërpërmendura bëhen në prani të prindit/prindërve.

12. Për rastet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, çeku lëshohet në emër të prindit/prindërve pasi foshnja regjistrohet si shtetas i Republikës së Shqipërisë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

13. Për foshnjën e lindur në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe të braktisur nga prindi/prindërit, për emetimin e çekut për kujdestarin ligjor të fëmijës, merren parasysh afatet për marrjen e kujdestarisë ligjore, sipas legjisllacionit në fuqi.

14. Pas verifikimit, nëpunësi i autorizuar i shërbimit spitalor plotëson dy çeqe. Çeku i parë do të jetë në vlerat e përcaktuara në pikën 4, të kreut II, të këtij vendimi.

15. Çeku i dytë do të jetë në masën prej 5 000 (pesë mijë) lekë dhe do të emetohet nga banka pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

16. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor publik ose jopublik, çdo ditë të hënë, bën bilancin e të gjitha dokumenteve “Certifikatë asistence në lindje” të mbajtuara gjatë javës pararendëse dhe të dorëzuara nga institucioni i shërbimit spitalor, sipas pikës 2, të këtij kreu, duke evidentuar ato raste për të cilat është mbajtur akti i lindjes.

17. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, për rastet kur prindi/prindërit refuzojnë të bëjnë regjistrimin e foshnjës së lindur pranë institucionit të shërbimit spitalor ku ka ndodhur lindja, i dërgon Zyrës së Gjendjes Civile të vendbanimit të nënës dokumentin “Certifikatë asistence në lindje”, së bashku me dokumentin e identitetit të prindit/prindërve.

18. Nëpunësi i gjendjes civile pranë institucionit të shërbimit spitalor i dërgon informacion me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, çdo ditë të hënë, për dokumentet “Certifikatë asistence në lindje”, të mbajtuara në javën pararendëse dhe të përcjella për veprim të mëtejshëm në zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të nënës.

19. Në rastin kur akti i lindjes nuk mbahet në institucionine shërbimit spitalor, prindi/prindërit ose njëri nga personat e parashikuar nga ligji i shërbimit të gjendjes civile, për deklarimin e lindjes paraqiten pranë zyrës së gjendjes civile ku kanë vendbanimin. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pas paraqitjes së deklaruesit, kryen veprimet sipas legjislacionit në fuqi dhe pajis me certifikatat e nevojshme deklaruesin.

20. Nëpunësit e zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin prindi/prindërit, të cilit i ka ardhur njoftimi “Certifikatë asistence në lindje”, verifikon fillimisht nëse është regjistruar foshnja e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëse foshnja nuk është e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile e regjistron atë në Regjistrin e Përkohshëm.

21. Pas regjistrimit të foshnjës në Regjistrin e Përkohshëm, nëpunësi i gjendjes civile vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjendjen civile.

22. Në rastet kur lindja ka ndodhur në shërbimin spitalor jopublik të licencuar sipas legjislacionit në fuqi, prindi/prindërit pasi e regjistrojnë foshnjën në zyrën e gjendjes civile, pajisen me certifikatën personale nga akti i lindjes dhe familjare me shënimin:

“Lindje në institucion jopublik (emri i institucionit), lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare” (Bonusi), për t’u paraqitur pranë Shërbimit Social Shtetëror për tërheqjen e çekut, sipas vlerave të përcaktuara në këtë vendim. Përfituesit e çeqeve paraqesin pranë Shërbimit Social Shtetëror:

- a) certifikatën e lindjes, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
- b) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
- c) kartat e identitetit të prindit/prindërve.

25. Në rastet kur akti i lindjes është mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile pasqyron lindjen në RKGJC, sipas

procedurës. Nëpunësi, pasi verifikon nëse lindja është pasqyruar sipas afateve ligjore brenda 90 ditëve pajis deklaruesin me certifikatën personale e familjare me shënimin:--Lindje jashtë shtetit, nr... akti, datë...,muaj..., viti, vendin ku ka ndodhur lindja, lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare, regjistruar brenda afatit 90-ditor (Bonusi),i cili do të paraqitet pranë Shërbimit Social Shtetëror për tërheqjen e çekut, sipas vlerave të përcaktuara në këtë vendim. Përfituesit e çeqeve paraqesin pranë Shërbimit Social Shtetëror:

- a) certifikatën e lindjes, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
- b) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
- c) kartat e identitetit të prindit/prindërve.

26. Në rast se deklarimi i aktit të lindjes të mbajtur jashtë vendit kryhet jashtë afatit 90-ditor, nëpunësi i gjendjes civile kryen pasqyrimin e lindjes në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pajis deklaruesin me certifikatën personale e familjare me shënimin:--Lindje jashtështetit,nr..akti,datë..., vendin ku ka ndodhur lindja, “Për përfitim të ndihmës së menjëhershme financiare Bonus, regjistruar jashtë afatit 90-ditor, nuk përfiton çekun prej 5 000 pesë mijë lekësh). Në këto raste prindi/prindërit nuk përfitojnë pagesën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

27. Për të gjitha rastet që nuk janë parashikuar nga ky vendim veprohet sipas legjislacionit në fuqi.

28. Tërheqja e çekut (Baby Bonus) bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës, për foshnjat e lindura brenda ose jashtë shtetit.

29. Të gjitha institucionet e shërbimit spitalor, publike dhe jopublike, që kanë shërbimin e lindjes së foshnjës, duhet të bëjnë me dije dhe të kenë të njoftuar në mënyrë publike se në institucionin e tyre ofrohet edhe shërbimi i gjendjes civile për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të foshnjës së porsalindur.

30. Drejtuesi i shërbimit spitalor, publik dhe jopublik,i licencuar sipas legjislacionit në fuqi, ka detyrimin t’i ofrojë kushte pune dhe një mjedis të përshtatshëm nëpunësit të shërbimit së gjendjes civile, brenda institucionit për kryerjen e detyrave të tij, sipas legjislacionit në fuqi.

IV. SANKSIONET

1. Zbatimi i përcaktimeve të bëra në këtë vendim nga ana e institucionit të shërbimit spitalor publik dhe/ose jopublik, që ka shërbimin e lindjes së foshnjës, është subjekt kontrolli nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Në rast se strukturat përgjegjëse konstatojnë përfitimin pa të drejtë të ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr masa, sipas legjislacionit në fuqi, për kthimin e shumës së përfituar pa të drejtë.

3. Shkelja e përcaktimeve të bëra në këtë vendim nga ana e institucionit të shërbimit spitalor, publik dhe/ose jopublik, që ka shërbimin e lindjes së foshnjës, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ndihma e menjëhershme financiare (Bonusi) do të jepet sipas përcaktimeve në vendimin nr.740, datë 12.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij”, për të gjithë përfituesit që kanë nisur procedurat për marrjen e këtij përfitimi, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Vendimi nr.740, datë 12.12.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama